



E Mërkurë
16 Maj 2012
Nr: 123 (6339)
E përditshme e pavarur
Viti i XXII i botimit
www.kohajone.com
Çmimi 20 Lekë

Koha Jonë



Botues: Aleksandër Frangaj - Kryeredaktor: Edison Kurani

Katër orë debat i ashpër në Komisionin e Reformës Zgjedhore, asnjë rezultat edhe pas afatit të shtyrë

Dështojnë negociatat, PS del kundër ODIHR

Përplasje për numërimin elektronik dhe përbërjen e KQZ. PD siguron se do t'i bindet rekomandimeve të ndërkombëtarëve. PS del kundër kërkesës së ODIHR, për mosaplikimin e leximit dixhital të votave

FAQE 4

KATËRMUJORI

QKR: Janar-prill, u hapën 5824 biznese të reja

Bizneset e reja që po hapen në Shqipëri, përveçse janë më të shumta se ato që mbyllen, po figurojnë në rritje edhe nga viti në vit. Ky përfundim del nga të dhënat më të fundit të publikuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimeve (QKR), sipas të cilave, vetëm në 4 muajt e parë të këtij viti numërohen 5824 biznese të reja të hapura. Kujtojmë këtu, se në të njëjtën periudhë...

FAQE 9

NDRYSHIMI NE LIGJ

Biznesi: Tatimi mbi të ardhurat na penalizon

"Parapagimi në çdo 3 muaj i tatimit fitimit përbën një kosto shtesë dhe të palogjikshme, e cila do ta vendosë në shumë vështirësi financiare biznesin". Me një deklaratë të tillë, kreu i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, Nikolin Jaka, ka shpjeguar ndikimin që sipas tij do të kenë tek sipërmarrjet shqiptare ndryshimet e fundit të kryera në ligjin për Tatimin mbi të ardhurat"...

FAQE 10

INTERVISTA



Morina, një shqiptar në botën e VIP-ave të SHBA



Liliana Hoxha: Mehmet Shehun e vranë, Nexhmija dhe Ramizi, agjentë të KGB

INTERVISTA E PLOTE/ Liljana dhe Sokol Hoxha e fëmijët e tyre, me Enver Hoxhën, në një foto familjare **FAQE 6-8**

AKUZA

Rama: Berisha po tenton të "blejë" dy deputetë të PS

FAQE 5

VENDIMI

Procedurë e re për njohjen e diplomave, detajet

FAQE 16

KËSHILLAT

Impotenca ka kapur rininë, mjeku Dani shpjegon shkaqet

FAQE 17

BULEVARDI I RI

Berisha: Pas betonizimit, Tirana metropol i denjë për qytetarët



FAQE 2-3

Koha TVETER

FESTA

Çiljeta ngre më këmbë stadiumin e "Skënderbeut"

GOSSIP

Diçka po ndodh me Ritën, Adelinën, "Jeri-cho" dhe Unikkatilin

FAQE 20-22



Drenusha Latifi: Lidhjen dhe dhuratat ia kam lënë kohës

INTERVISTA



Publikohen variantet përfundimtare të projektit, sot fituesi

Basha: Qytetarët vendosin për fituesin e bulevardit



Luljeta Ndoka

luljetandoka@kohajone.com

Qytetarët do të jenë ata që do të kenë një rol të madh në shpalljen e fituesit të projektit të zgjatimit të Bulevardit dhe rehabilitimit të lumit Tiranë. Kështu është shprehur kryetari i Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, gjatë ditës së dytë të aktivitetit për të diskutuar dhe më pas për të shpallur projektin më të mirë, i cili do të zbatohet projektin e mësipërm. "Në përzgjedhjen e projektit fitues të Bulevardit dhe rehabilitimit të lumit të Tiranës do të dëgjohej jo vetëm zëri i ekspertëve më të mirë vendas dhe ndërkombëtarë, por edhe i qytetarëve të Tiranës", - tha Basha. Në ditën e dytë të konkursit për përzgjedhjen e projektit të Bulevardit dhe rehabilitimit të lumit të Tiranës, arkitektët e studiove "DAR" dhe "Grimshaw" u janë përgjigjur pyetjeve të bëra nga anëtarët e grupit strategjik të Planit Urbanistik dhe pyetjeve të



Maketi i projektit e paraqitur nga studio "DAR"

adresuara nga qytetarët, gjatë periudhës një mujore, që maketet u ekspozuan në Muzeun Historik Kombëtar. "Ne ndodhemi shumë afër finishit të kësaj gare, e cila ka pasur si garues, ndër atletët më të shquar të arkitekturës botërore, megjithatë gara nuk ka përfunduar. Ne u japim sot mundësi qytetarëve të Tiranës, të jenë jo thjesht pjesëmarrës, por edhe bashkëvendimmarrës, në këtë vendim të

jashtëzakonshëm për të ardhmen e qytetit të tyre", - tha kryetari i Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, Sipas tij, impakti që projekti ka është një impakt kombëtar. "Kjo është arsyeja se pse që nga gjeneza e projektit, kemi marrë inkurajimin dhe mbështetjen e qeverisë shqiptare, në veçanti të Kryeministrit të Shqipërisë dhe kjo është edhe arsyeja se pse si kryetar i Bashkisë, unë ndihem shumë i nderuar që ai ndodhet sot këtu", - u shpreh Basha. Gjatë ditës së djeshme, dy studiot finaliste kanë shpallur projektet e tyre përfundimtare për bulevardin dhe Lumin e Tiranës. Kështu, janë bërë disa saktësime që lidhen pikërisht me nevojat e kësaj zone. "Grimshaw" i ka kushtuar rëndësi pasurisë së paluajtshme. "Kemi sugjeruar një autobus që funksionon me hidrogjen, që mund të fillojnë nga puna së shpejti, sugjeruam gjithashtu edhe një pavijon të ri, i cili do të jetë lart mbi kodër, pranë Paskuqanit, një platformë për të parë pikërisht atë që mund të shikohet, se si qyteti vjen drejt kësaj platforme", - thanë përfaqësuesit. Pjesa tjetër është lëvizshmëria, që ka të bëjë me linja të tramvajit apo linja të tjera që mund të lidhin aeroportin me qytetin, në një mënyrë mjaft mod-



Dje kryeministri Berisha, gjatë aktivitetit për projektin e zgjerimit të Tiranës

erne të transportit të menjëhershëm, pa ndalesa që mund të shkojnë në kahun e kundërt apo që mund të lidhin zona suburbane. Ndërsa studioja "DAR" ka punuar tek të konsideruarit e Bulevardit më në thellësi, i cili ka qenë faza e parë dhe elementi i parë. "Kemi bërë një rishikim të planit, një ngushtim të gjerësisë së bulevardit, të cilat ne menduam se ishin tepër të rëndësishme për konceptimin e

skemës sonë", - thanë përfaqësues të kësaj studioje. "Sipas tyre, elementi kryesor për ta sjellë qendrën e qytetit ka lidhje me zgjerimin, me bashkimin e disa pikave, qoftë tregtare dhe për periudhën afatgjatë nuk janë propozuar ende pjesa jugore e bulevardit në pjesën fundore për një qendër tregtare dhe qytetare, si dhe për të ofruar shërbime publike për qytetarët.

"GRIMSHAW"

Propozimi, 3 sheshe në bulevard dhe parkingje

Sipas studios arkitekturore "Grimshaw", rrugët brenda tij zonës së projektit janë dizajnuar si rrugë të vogla për makina, për sistemin e këmbësorëve, transportin publik, pra për të shijuar qytetin. Kjo studio u jep prioritet këmbësorëve dhe ka shtuar një element të ri për t'i dhënë zgjidhje trafikut. Bëhet fjalë për ndërtesat me kate, ku mund të parkojnë makinat. Parashikohet që përgjatë bulevardit të jenë 3 sheshe. Sipas projektit të ri të kësaj studioje, gjerësia e tij do të jetë 60 metra. "Në strategjinë e parkimit jemi përqendruar në një strategji elastike dhe mendojmë se mund të përdorim parkingjet e makinave si ndërtesa konike në mënyrë që njerëzit të dinë se mund të shkojnë atje dhe të fillojnë të shijojnë, të ecin në qytet apo sistemet e autobusëve. Do të ketë kate nën dhe që do të lejojnë që të ketë një lloj peizazhi, mund të ndihmojnë edhe në mbrojtjen e hapësirave tregtare", - thanë përfaqësuesit e kësaj studioje. Sipas tyre, me rëndësi është pastrimi i lumit, për këtë do të ketë programe dhe këtu duhet të marrë pjesë i gjithë komuniteti. Ruajtja e specieve dhe habitateve është gjithashtu i rëndësishëm për biodiversitetin e lumit. Mund të ketë aspekte të biçikletave, hipizmit.

"DAR"

"Do të zhvendosim kullat dhe ngushtojmë bulevardin"

Studioja "DAR" ka vendosur të ngushtojë gjerësinë bulevardit nga 170 metra në 100, si dhe të ulë koston e zbatimit të projektit. "Sa i takon rishikimit të masterplanit dhe punës që kemi bërë, u jemi rikthyer ndërtesave që do të ruheshin dhe që do të hiqeshin në pjesën jugore, ndërsa në lidhje me pjesën veriore të bulevardit ekzistues, pamë gjerësinë midis ndërtesave ekzistuese në fund të pjesës veriore për të parë se cilat ndërtesa duhet të mbanim, dhe një pjesë prej tyre janë të evidentuara në qendrën tregtare e disa të tjera që janë të rëndësishme për qytetin. Në bazë të këtyre ndryshimeve ne e kemi bërë gjerësinë deri në 100 metra", - thanë përfaqësues të studios. Elementi kryesor për ta sjellë qendrën e qytetit ka lidhje me zgjerimin, me bashkimin e disa pikave, qoftë tregtare dhe për periudhën afatgjatë nuk janë propozuar ende pjesa jugore e bulevardit në pjesën fundore për një qendër tregtare dhe qytetare, si dhe për të ofruar shërbime publike për qytetarët. Elementi i fundit bën fjalë për zonat ekzistuese, të cilat janë paraqitur me ngjyrë të verdhë. Faza afatmesme lidhet me kopshtet, ku do të ketë kombinime ndërtimi dhe do të pritet kush të zhvillohet më parë. Kampusi do të shihet më vonë, pasi më parë do të mendohet për nënstacionin.



Bulevardi i ri, kryeministri: Në qendër të gjithçkaje, qytetari

“Fund betonizimit, Tirana metropol i denjë për qytetarët”



Eva Gjura

evagjura@kohajone.com

Projekti për zgjatimin e Bulevardit dhe rehabilitimin e lumit të Tiranës duhet të vërë në epiqendër qytetarin. Kështu është shprehur dje kryeministri Berisha gjatë fjalës së tij për fazën e dytë të konkursit për zgjedhjen e projektit të Bulevardit dhe rehabilitimit të lumit të Tiranës. Kreu i qeverisë duke vlerësuar garën e bërë deri më tani ka theksuar faktin se projekti fitues duhet të jetë në funksion të qytetarit dhe hapësirave që atij i duhen për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm. Lidhur me mjedisin e shëndetshëm, i cili në Tiranë lë mjaft mundësi diskutimi, kryeministri Berisha nuk ka hezituar të akuzojë ish-kryebashkiakun Rama për betonizimin që i ka bërë Tiranës gjatë kohës që ai ka drejtuar bashkinë e kryeqytetit. "Sot përfundon projekti i Tiranës së shekullit të 21-të, e cila ka një nga vendndodhjet më të bukura, më magjepsëse, më ekologjike, më të mrekullueshme në kontinent e më gjerë, por që u viktimizua nga babëzia njerëzore", - tha Berisha. Kryeministri u ndal tek betonizimi në 10-vjeçarën e fundit që iu bë kryeqytetit, të cilin e cilësoi një barbari njerëzore që rrënoi mjedisin dhe hapësirën, ndërsa apeloj për një tiranë metropol që me dinjitet të bashkëpunojë edhe me metropolet e tjera të vendit. "Qyteti njohu një barbari njerëzore, sepse kur betoni përdoret për të rrënuar mjedisin dhe hapësirat, atëherë rëndësia e veprës suaj bëhet disa herë më e madhe. Në këtë përzgjedhje do të vendosim për Tiranën një metropol që me dinjitet të shëmbëllej dhe bashkëpunojë me metropolet e tjera europiane është kusht themelor i ekzistencës", - ka deklaruar kryeministri Berisha. Për kryeministrin, zgjedhja e Tiranës kryeqytet nuk është fare e rastësishme, pasi ka përputhje të plotë me përkrahimin që Sami Frashëri i ka bërë vendndodhjes së kryeqytetit të shqiptarëve duke evidentuar bukurinë e tij natyrore. Kreu iu qeverisë është kthyer pas në kohë, duke bërë një retrospektivë të kryeqytetit që pas daljes nga perandoria otomane dhe deri në ditët e sotme. Berisha tha se qyteti njohu një batërdi të



Maketi i projektit e paraqitur nga studio "Grimshaw"

VIZITA

Shqipëri-Turqi, bashkëpunim shumë i mirë politik dhe ekonomik

Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli, ka pritur në një takim të veçantë kryetarin e Asamblesë së madhe të Turqisë, Çemil Çiçek. Gjatë këtij takimi, si kryeparlamentarja Topalli, si kreu i asamblesë Turke, Çiçek, kanë theksuar se marrëdhëniet mes Turqisë dhe Shqipërisë janë të shkëlqyera. Gjatë fjalës së saj, Topalli ka theksuar se Turqia është më shumë se një partner strategjik. Gjithashtu, ajo ka evidentuar faktin se biznesi turk ka 10-fishuar investimet në vend, duke u kthyer në një partner të rëndësishëm ekonomik dhe jo vetëm politik, ndërkohë që falënderoi për mbështetjen në njohjen e Kosovës. Nga ana e tij, z. Çiçek ka vlerësuar si një nder të veçantë që kjo vizitë zhvillohet në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë. "Uroj që pavarësia e Shqipërisë të jetë e përjetshme. Midis vendeve tona ka marrëdhënie të ngushta miqësore dhe vëllezërore. Për ne është shumë e rëndësishme ruajtja e paqes dhe stabilitetit në rajon. Sa më shumë ritëm në marrëdhëniet e bashkëpunimit aq më i madh kontributi ynë për sigurinë në Ballkan. Ka shumë arsye për këtë. Ka dhe parlamentarë turq që kanë origjinën shqiptare edhe marrëdhëniet kulturore kanë lidhje me këtë. Sa më shumë të forcohen marrëdhëniet mes dy vendeve aq më mirë do të jetë për vendet e rajonit", - ka deklaruar Çiçek. Ndërkohë, duke iu referuar pikërisht përbërjes së delegacionit turk, në të cilin bëjnë pjesë dhe parlamentarë me origjinë shqiptare, ku Topalli tha se "zoti Kryeministër ka pasur të drejtë kur ka thënë se ka shumë gjak shqiptar tek populli turk". Kryetarin e Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, z. Çemil Çiçek dhe delegacionin e parlamentarëve turq që e shoqëronte e ka pritur dje edhe kryeministri Berisha, i cili ka vlerësuar marrëdhëniet shumë të mira që ekzistojnë mes dy vendeve tona.

Berisha: Do thellojmë masat integruese për egjiptianët

Kryeministri Berisha ka zhvilluar dje një takim me një grup përfaqësuesish të komunitetit egjiptian në Shqipëri. Përfaqësuesit e këtij komuniteti, pasi e kanë falënderuar kryeministrin për pritjen, e kanë njohur atë me përpjekjet e tyre për zhvillimin social-ekonomik të tij. Më tej, ata i kanë shprehur kryeministrin disa nga shqetësimet që prekin këtë komunitet. Nga ana e tij, kryeministri ka shprehur mbështetjen e tij për përpjekjet e komunitetit egjiptian për të ecur përpara, si pjesë integrale e shoqërisë shqiptare dhe jashtë parajshkimeve. Kryeministri shprehu angazhimin që qeveria do të thellojë masat për integrimin më të mirë të këtij komuniteti në shoqërinë shqiptare, e në mënyrë të veçantë në drejtim të integritit social, arsimimit, punësimit etj.

vërtetë, dhe se arkitektura ishte mjerim i vërtetë, por, - ka shtuar ai, - nuk mund të thuhet e njëjta gjë për urbanistikën, për të cilën pati përpjekje për të ruajtur hapësira dhe një respekt hapësinor u trashëguua. Më pas, gjatë fjalës së tij, kryeministri ka vlerësuar punën e bërë aktualisht nga kryebashkiaku i ri, Basha, i cili në pak kohë bëri një ndryshim të shpejtë dhe jetik, siç ishte sheshi "Skënderbej", i cili, sipas Berishës, ishte më i egër se vetë egërsia. Berisha kërkoi që të mbahet parasysh nisma e Tiranës qytet i shëndetshëm edhe në përzgjedhjen e projektit të ri. Kryeministri tha se kjo nisim është shumë të rëndësishme për qytetarët e Tiranës, sepse është faktuar se 40% e vdekjeve të njeriut vijnë nga ndotjet e ujit, ajrit dhe tokës, ndërsa vlerësoi edhe shoqërinë civile për avokatinë që i bën

mbrojtjes së Mjedisit. "Projekti duhet të ketë parasysh ansamblin natyror të kryeqytetit. Nuk ka një ansambël natyror më të bukur sesa ky i Tiranës", - tha Berisha. Gjithashtu, kryeministri garanoi se do të mbështesë në gjithçka Bashkinë e Tiranës që kryeqyteti të shndërrohet në një metropol të denjë për shqiptarët, pasi, sipas tij, kjo është ëndrra jo vetëm e qytetarëve të Tiranës, por e të gjithë shqiptarëve. "Qeveria është e vendosur t'ju mbështesë plotësisht. Qeveria ka qenë e gatshme të mbështesë edhe pararendësin tuaj, pro ai kishte interesa të tjera dhe jo ato të qytetarëve të Tiranës. Ndaj, dhe unë ju garantoj se do të mbështesim fuqishëm projektet e transformimit të Tiranës në një metropol europian, të denjë për shqiptarët dhe kombin shqiptar", - u shpreh kryeministri.

PD, pro propozimeve të ODIHR për numërimin elektronik, s'pranon PS



Rozeta Rapushi

rozetarapushi@kohajone.com

Dështojnë negociatat 4-orëshe PD-PS për reformën zgjedhore

Më shumë se katër orë diskutimi me dyer të mbyllura nuk mjaftuan që anëtarët e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore të përfundojnë punën me Kodin e ri Zgjedhor. PD-PS u ndanë sërish dje për dy çështje thelbësore, si aplikimi apo jo e numërimit elektronik në zgjedhje apo përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke tejkalluar edhe afatin e shtyrë që reforma zgjedhore të përfundonte brenda 15 majit. "Nuk arritëm konsensus për disa çështje. Diskutuam gjatë, shpresojmë që brenda datës 24 maj, të gjejmë një zgjidhje të pranueshme", - u shpreh bashkëkryetari socialist i komisionit, Damian Gjicknuri. Sipas tij, çështja në ditët në vijim, negociatat mes palëve, duhet të vijojnë në filtra të tjerë parlamentarë. "Tekstet janë gati, propozimet janë gati, por kompromisi nuk është gjendur. Negociatat duhen vazhduar në filtra parlamentarë", - u shpreh Gjicknuri, duke lënë të kuptohet se tashmë nevojiten të tjera negociata veç atyre të komisionit, pse jo në Komisionin Parlamentar të Ligjeve, apo edhe mes forcave politike dhe ekspertëve. Ndërkohë që ekspertët e Partisë Demokratike, Oerd Bylykbashi, shpjegoi arsyet e mosgjetjes së kompromisit. Sipas Bylykbashit, një nga pikat ku nuk u arrit konsensusi është zbatimi apo jo i numërimit elektronik të votave në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Një proces ky që nuk sugjerohet nga ODIHR dhe për këtë arsye PD shprehet tërësisht dakord, por PS nuk pranon tërheqje nga ky proces. "U ndalëm gjatë tek zbatimi i komentëve të ODIHR në lidhje me teknologjinë e numërimit. Debati zgjati shumë, palët ndahen nëse duhet të zbatohen rekomandimet e ODIHR, apo duhet një zbatim i pjesshëm i tyre. Ne jemi të mendimit që nuk ekziston asnjë mundësi që dispozitat e ardhshme të Kodit Zgjedhor të mos marrin parasysh çdo element të rekomanduar nga OSBE/ODIHR", - tha Bylykbashi, duke sqaruar kështu që mazhoranca mbështet tërësisht rekomandimet e ODIHR, që në thelb e cilësojnë të nxituar dhe të papërshtatshëm aplikimin e numërimit elek-



Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore

Komisioneri, apel që reforma të jetë gati para zgjedhjes së Presidentit

Fyle: Brenda 24 majit, mbyllni punën me reformën zgjedhore

Komisioneri Europi Kan për Zgjerimin, Stefan Fyle, kërkon nga politika shqiptare që të përfundojë brenda datës 24 maj reformën zgjedhore. Këtë limit, Fyle e vuri dje në Bruksel, gjatë takimit të katërt të Këshillit të Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri, një prej forumeve më të larta ku u diskutua ecuria e zhvillimeve në Shqipëri. Apel ky që erdhi pas disa shtyrjesh të vazhdueshme që komisionit iu bënë me vendim të Kuvendit. "Dua t'ju them se jam i shqetësuar që reforma zgjedhore nuk ka mbaruar akoma, me gjithë diskutimet që po bëhen për këtë qëllim. E di se ka një angazhim nga të dyja palët dhe është bërë shumë për këtë reformë elektorale. Është themelore që pikat e marrëveshjes së nëntorit të



Komisioneri për Zgjerimin, Stefan Fyle

mbylljen para fillimit të procedurës për zgjedhjen e presidentit. Procesi nis më 24 maj dhe kanë mbetur edhe pak ditë. Pra, është themelore që marrëveshja të finalizohet para këtij afati", - bëri të qartë dje gjatë takimit, para përfaqësuesve të mazhorancës dhe opozitës. Nga ana tjetër, duke komentuar zgjedhjet në prag për Presidentin e ri të Repub-

tronik në zgjedhjet e 2013-s, pasi nevojitet më shumë kohë për të. "Nuk mund të vihet në diskutim arritja e konsensusit nëpërmjet vendosjes së kushteve. Ne do të

eksplorojmë të gjitha mundësitë që parlamenti na lejon. Duhet t'u shmangemi tentativave për pozicionet politike. Kompromisi arrihet shumë shpejt,

nëse zbatohen rekomandimet e OSBE/ODIHR", - bëri thirrje Bylykbashi pas mbledhjes që zgjati deri në orën 21:40 të mbrëmjes së djeshme. Tashmë pritet të

AKUZA

Kryetari i grupit parlamentar Demokrat, Astrit Patozi, akuzoi dje kreun socialist, Edi Rama, se qëllimisht pengon Reformën Zgjedhore dhe Parlamentare për t'i lidhur ato me zgjedhjen e Presidentit. Sipas Patozit, PD mbështet rekomandimet e ODIHR sipas së cilave, numërimi elektronik është i parakohshëm. Tjetër çështje, sipas tij, është përbërja e KQZ-së, ku PS kërkon që të përfshijë edhe Avokatin e Popullit si institucion për të propozuar anëtarë.

Ekip nga Brukseli, në Tiranë për reformën në drejtësi

Ministria e Integritetit, Majlinda Bregu, tha dje se një ekip nga Brukseli do të mbërrijë javën e ardhshme për të parë nga afër, punën me reformën në drejtësi. "Do të kemi javës tjetër dhe një mision tjetër në Shqipëri, i cili do të merret kryesisht me çështjet e drejtësisë. Besoj se janë elementë për të bindur jo vetëm komisionin, por edhe vendet anëtare për ndryshimet që janë bërë që nga nëntori", - u shpreh dje pas takimit BE-Shqipëri, Ministria e Integritetit. Ndërsa përfaqësuesi i opozitës, kryetari i Komisionit të Integritetit, Ditmir Bushati, theksoi rëndësinë që ka zbatimi i marrëveshjes politike të 14 nëntorit. "Në mënyrë që të konsiderohet e përmbyllur kjo marrëveshje, do të duhet që të përfundojë reforma zgjedhore dhe ajo parlamentare përpara se Parlamenti të përfshihet në zgjedhjen e presidentit të ri", - tha Bushati. Raportimi i radhës për ecurinë e plotësimit të rekomandimeve të Komisionit Europian do të jetë në muajin qershor.

Haxhinasto: Zgjidhja e presidentit, sipas Kushtetutës

Ministri i Jashtëm, Edmond Haxhinasto, i vlerësoi dje si pozitive para ndërkombëtarëve zhvillimet politike. Me gjithë problemet e fundit, ngërçin në reformën zgjedhore apo parlamentare, Haxhinasto tha se situata politike në Shqipëri ka ndryshuar pozitivisht. "Takimi u zhvillua në një klimë të re, ka një progres të qartë. Sot arritëm në përfundimin se Shqipëria i ka të gjitha kapacitetet për të plotësuar rekomandimet e kërkuara për marrjen e statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Europian", - u shpreh Haxhinasto. Nga ana tjetër, duke komentuar edhe procesin e zgjedhjes së presidentit që do të nisë së shpejti, ai tha se "konfirmojmë se për zgjedhjen e presidentit dhe procesi do të jetë konform Kushtetutës dhe do të jetë një sinjal se situata politike do të jetë konform marrëdhënieve me BE, por edhe në respekt të institucioneve". Një kërkesë kjo e bërë edhe nga Komisioneri për Zgjerimin, Stefan Fyle, gjatë takimit BE-Shqipëri.

sur një ndryshim dramatik të atmosferës në Shqipëri. Dua të vlerësoj punën e të gjitha palëve në Shqipëri", - shtoi Fyle. Komisioneri theksoi faktin se zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, sipas kodit të ri dhe në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare, do të ishin një inkurajim pozitiv që vendet anëtare të merrnin një vendim. "Unë po punoj me kolegët duke ndihmuar autoritetet shqiptare që të arrijnë pjesën më të madhe të prioritetëve që statusi për vendin kandidat të arrihet këtë vit. Nuk po punoj që të pres që të punoj për zgjedhjet që parashikohen vitin tjetër", - tha ai.

zgjidhet se si do të vijojnë negociatat mes palëve, nëse do të ketë një tjetër shtyrje të afatit të punës së komisionit, apo do të zgjidhet në rrugë të tjera parlamentare.

REFORMA

"KQZ duhet të riformulohet"

Partia Socialiste kërkon riformulimin e përbërjes së KQZ-së aktuale duke e cilësuar si një kusht të domosdoshëm për garantimin e zgjedhjeve të ardhshme. Në mbledhjen e djeshme të Grupit Parlamentar të PS-së, kryesocialisti Edi Rama u shpreh se komisioni që po punon për ndryshimin e Kodit Zgjedhor duhet të zgjidhë 5 problemet që janë ngritur nga raporti i OSBE/ODIHR. "Administrimi, nuk besoj se ka shqiptar që të mos mirëkuptojë qëndrimin tonë se KQZ-

ja duhet të riformulohet dhe padyshim të zgjidhet mbi bazën e riformulimit. Nuk dua të bëj komente, të cilat cenojnë frymën e domosdoshme konstruktive që duhet të vazhdojmë të ushqejmë, pavarësisht komenteve krejt pa vend, krejt pa etikë dhe krejt të pa dobishme, të kryeministrit dje", - u shpreh dje Rama. Ai ka theksuar se reforma zgjedhore duhet të zgjidhë problemet me: listat e zgjedhësve, identifikimin e zgjedhësve, numërimin, administrimin dhe procesin e animimit.



Kreu i PS, Edi Rama, në një mbledhje Grupi Parlamentar



Qamil Xhani

qamilxhani@kohajone.com

Kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama, deklaroi dje në mbledhjen e Grupit Parlamentar të selisë rozë se ka pasur tentativë të mazhorancës për të blerë deputetë për votimin e kreut të ri të shtetit. Kreu i PS-së nuk ka përmendur emra, por ka theksuar se bëhet fjalë për dy deputetë, të cilëve u janë ofruar para në këmbim të votës. "Mbrëmë dhe të shtunën mbrëma, dy deputetë socialistë janë vendosur përpara ofertës në para të të dërguarve të kryeministrit për të dhënë votën e tyre për kandidaturën e Partisë Demokratike për President të Republikës", - u shpreh kreu i PS-së, Edi Rama. Duke e cilësuar këtë si një tentativë për të zgjedhur kreu e shtetit pa konsensus, Rama theksoi se opozita nuk do të pranojë asnjë president të zgjedhur vetëm nga ana e mazhorancës. "Duam një President konsensual. Duam një President që të mishërojë unitetin kombëtar në këtë kohë sfidash të mëdha për shqiptarët jo vetëm si shtet, por edhe si komb. Duam një President që të garantojë Kushtetutën, institucionet kushtetuese dhe aktivitetin kushtetues të tyre", - tha Rama. Në këtë linjë, ai ka argumentuar

dhe takimin me kreun e LSI-së dhe faktorët e tjerë politikë. "Ne kemi komunikuar dhe do të vazhdojmë të komunikojmë me çdo palë që është e gatshme të komunikojë me ne. Kemi hapur një komunikim me LSI. Do të vazhdojmë të komunikojmë. Kemi hapur një komunikim me PDIU-në", - u shpreh Rama. Kreu i PS-së ka theksuar se për zgjedhjen e një presidenti konsensual, PS do të bëjë negociatë dhe me Partinë Demokratike. "Presim të komunikojmë edhe me PD-në dhe me faktorët e tjerë politikë në parlament, me PR-në, me FRD-në dhe padyshim do të jemi në komunikim të pandërprerë me PBDNJ-në. Shqipërisë i duhet kjo që po bëjmë", - tha dje Rama. Nga ana tjetër, Rama ka përsëritur qëndrimin e Partisë Socialiste për mospranimin e një kandidati që të jetë zgjedhur nga ana e Partisë Demokratike. "Dhe nuk synojmë të imponojmë asnjë emër nga Partia Socialiste. Sepse, nuk duam thjesht një President që të mos jetë nxjerrë nga barku i oborrit të Saliut, po duam një President që të mos jetë noter i cilësdos parti, përfshirë edhe Partinë Social-

iste", - u shpreh dje Rama. Në takimin e përjavshëm me deputetët, Rama ka kërkuar dhe garanci për zgjedhjet dhe ndryshimin e Kodit Zgjedhor. "Procesi i reformës ka pasur dhe i ka të gjitha gjasat të mbyllet me sukses, në të mirë të vendit, në të mirë të të gjitha forcave elektorale që pastaj mishërohen në forca parlamentare. Është bërë

PD:

"Rama fantazi të sëmure, akuzat t'i dërgojë në Prokurori"

Partia Demokratike ka hedhur poshtë dje akuzat e kryetarit të Partisë Socialiste, Edi Rama, se PD ka dashur të korruptojë deputetë socialistë. Zëdhënësjja e selisë blu, Silvi Bardhi, gjatë një deklarate për shtyp tha se kryetari i PS-së të paraqesë në prokurori të gjitha provat, faktet dhe të bëjë publik emrat, të cilët pretendon se janë tentuar të blihen, sipas PD-së, ky do të ishte një detyrim madhor për luftën kundër korrupsionit politik. Për selinë blu, nëse PS-ja nuk e bën një gjë të tillë, atëherë këto akuzë mbetet thjesht një gënjeshtër e radhës e bazuar në mashtrim. "Edi Rama, lëshoi shashkën e radhës dhe akuzoi pa emra, për përpjekjen që, sipas tij, Partia Demokratike ka bërë për të korruptuar deputetë të tij. Partia Demokratike, duke hedhur poshtë këto akuza vulgare, produkt i një fantazie të sëmure, i kërkon zotit Rama, që çdo provë, fakt, apo të dhënë për cilindo, ta paraqesë në Prokurorinë e shtetit, si një detyrim madhor për luftën kundër korrupsionit politik, në të kundërt kjo akuzë bëhet një gënjeshtër e radhës e bazuar në mashtrim. Dhe do të duhet që shqiptarët të presin nesër deklaratën e radhës, në të cilën z. Rama të shpallë se Berisha po tenton ta blejë atë", - thuhet në deklaratën e Partisë Demokratike.

Kryesia e PS: Nuk pranojmë asnjë kandidat të PD

Rama: Berisha po tenton të blejë deputetë të PS

hap ko-nkret shumë i rëndësishëm dhe shumë i dobishëm lidhur me administrimin e listave të zgjedhësve", - u shpreh dje Rama. Lidhur me akuzat e kryeministrit ndaj opozitës, Rama u shpreh se dy forcat kryesore nuk duhet të humbasin më kohë me debate, por duhet të gjejnë konsensus për miratimin e të gjitha detyrave, me qëllim mar-

rjen e statusit të vendit kandidat. "Rimarrja e avazit të vjetër, të fajësimit të opozitës nuk na bën përshtypje, por na shqetëson, sepse bie ndesh me çka i duhet vendit dhe me çka duhet të bëjmë së bashku. Sot, për politikën shqiptare, në raport me sfidat që kemi përpara, vlen si rrallë herë shprehja e urtë e popullit 'Koha është flori', - u shpreh dje kreu i



SALUS SPITALI ITALIAN
MULTISPECIALISTIK

ME "SALUS" CILESIA ITALIANE NE TIRANE

Laboratori i ri Italian Salus

Shërbimet:

- Analiza Kimike / Biokimike
- Analiza Hematologjike
- Koagulimi i Gjaktit
- Analiza Sierologjike
- Analiza Bakteriologjike
- Markues Tumoralë
- Markues Virale
- Analiza Hormonale
- Analiza Toksikologjike / Dozim Drogerash
- Dozimi i Medikamenteve
- Biologji Molekulare
- Matje e gazrave ne gjak

Laboratori i ri Italian Salus Tirane ne bashkepunim me Laboratorin Salus Trieste, sjell per here te pare ne Shqiperi:

- Diagnostikim te shpejte
- Validim - Certifikim on-line nga Mjek Italian ne Laboratorin Salus Trieste
- Cilesi Diagnostikuese sipas standarteve europiane
- Kalibrim i cilesise i përditshem te aparaturave
- Personel i trajnuar dhe profesionalisht i azhmuar ne laboratorin e analizave te Spitalit Salus Trieste
- Tarifa shume konkurruese

Salus Tirane Sh.A
rruga Vidhe Gjata 16,
Mëzez-Kashar, Autostrada TR-DR,
Tiranë, Shqipëri

per informacion:
Tel. +355 4 2390500
Mob. +355 662053180
Fax + 355 4 2390501
Mail info@salus.al
www.salus.al

INTERVISTA E PLOTE/ "Kur pashë "Diktatorin", kam qarë si çdo grua shqiptare"

Liliana Hoxha: Ramizi dhe Nexhmija, agjentë të KGB dhe UDB



Në familjen e Enver Hoxhës ka mbretëruar një situatë kaotike plot intriga, plane vrastare, spiunllëqe dhe gjueti shtrigash. E dy strumbullare të rëndësishme ishin Nexhmija dhe Teuta, gruaja e Enverit dhe nusja e djalit. Kështu mendon LOiljana Hoxha, nusja e djalit tjetër të Enver Hoxhës. Në një intervistë për gazetarin Blendi Fevziu në emisionin e mbrëmshëm "Opinion" në Tv Klan, Liliana Hoxha u ndal gjatë tek historia shumëvjeçare e diktaturës komuniste duke përmendur faktin sipas saj se familja e diktatorit ishte e përfshirë në agjencurat e huaja, madje me dëjtinë e vetë Enver Hoxhës. Duke u ndalur tek filmi "Diktatori" i gazetarit dhe shkrimtarit Blendi Fevziu, Liljana Hoxha tha se "unë pashë filmin dhe kam qarë siç ka qarë çdo grua shqiptare"

Zonja Hoxha, punë voluminoze të shkruash një libër prej 587 faqesh në të cilën tenton të hedhësh dritë mbi të shkuarën dhe të sotmen e Shqipërisë. Ose më saktë mbi të shkuarën dhe atë çfarë e shkuara vazhdon të transmetojë ende në shoqërinë e sotme apo jo?

E thatë shumë mirë, por mua më duhet t'ju falënderoj juve dhe më duhet t'ju uroj njëkohësisht që dëshmoni për një emancipim si gazetar, emancipim njerëzor jo vetëm profesional, që më ftoni të flas këtu, kur ju jeni një nga ata, që unë kam përmendur si shumë të tjerë pa pasur probleme personale për askënd. Por në daljen e përgjithshme të çështjes që unë ngre, më është dashur që të flas edhe për ata. Kështu që unë e çmoj shumë faktin që ju më keni ftuar mua këtu.

Zonja Hoxha, nuk ka asnjë lloj problemi në qoftë se ju keni kritika në drejtimin tim. Kjo është puna ime e përditshme. Unë intervistoj njerëz që më duan dhe që s'më duan, që më lëvdojnë apo kritikojnë. Kjo është puna ime dhe natyrisht isha shumë kurioz në momentin që mora librin, për ta parë atë dhe natyrisht për të parë atë që ju kishit shkruar në adresë time. Jam i hapur për të diskutuar për shumë gjëra. Por doja t'ju bëja një pyetje për të hyrë drejtpërdrejt në intervistë. Përse ky libër erdhi tani?

Erdhi tani sepse tani u poq, në kuptimin që u plotësua mund të them. Mund të vinte edhe më parë, por 2-3 vjet unë nuk kam qenë shumë mirë me shëndet dhe mbeti në sirtar ose kam botuar gjëra më të rralla. Vjen tani sepse në fund të fundit, kur them u poq, tani unë jam shumë e qartë për çfarë mendoj, për kush jam si individualitet, kush jemi ne shqiptarët, çfarë kemi kaluar, çfarë po kalojmë dhe se si duhet të kemi të ardhmen.

A jeni e sigurt që keni ende gjëra



për të thënë? Kam përshtypjen se ju keni shkruar shumë, keni folur shumë, keni dhënë intervista... A jeni e sigurt që nuk i keni thënë të gjitha, por ka ende gjëra për të thënë?

Kam shumë, shumë gjëra për të thënë, e kam thënë edhe herën e fundit. Janë hollësira që bindin më shumë lexuesin siç edhe e ngjethin më shumë atë. Si i dini ju këto gjëra? Ku i keni mësuar?

Ato që unë di, i di nga jeta ime. Kurse hollësira për njerëzit e tjerë, që normalisht unë nuk i njoh, as i kam takuar, as kam ndenjur me ta, përsëri i njoh në rrugë institucionale...

Ç'do me thënë në rrugë institucionale?

Domethënë ashtu siç di që unë kam qenë e ndjekur në kohën e diktaturës. Si keni qenë e ndjekur? Ju ishit nusja e djalit të Enver Hoxhës...

Kam pasur dosje në diktaturë. Nuk e di sa qe gjallë Enver Hoxha apo jo, por ka të ngjarë edhe atëherë.

E ndjekur nga kush? Kush tjetër veç Enver Hoxhës mund t'ju ndiqte?

Nga Sigurimi i Shtetit. Sot them nga Nexhmija Hoxha dhe Ramiz Alia. Përse Sigurimi i Shtetit duhet t'ju ndiqte?

Besoj për mënyrën se si më shikonin ata.

Keni fakte konkrete për këtë?

Kam fakte konkrete, dosja ka ekzistuar, nuk e di tani ekziston apo jo. Shumë njerëz m'i kanë shprehur këto dhe unë retrospektivisht i vërtetoj të tëra. Ndaj them kam shumë e shumë gjëra të tjera, ku ndërthehet e gjithë familja ime, motra, vëllai, martesat e tyre të detyruara nga Nexhmija. Martesat e vëllait dhe motrës time u bënë që të prishej martesa ime me Sokolin. Siç i di këto të gjitha tashmë, për një kohë të gjatë mezi i kam kuptuar, por i kam vërtetuar me shumë analiza, dëshmi, takime etj., ashtu di çdo gjë, shumë hollësira por kam shprehur vetëm të domozdoshtmet për ata njerëz që unë i kam përmendur aty në zbrëthim të çështjes. Për ta plotësuar këtë temë madhore që në të vërtetë është çështje kombëtare. Komunizmi ishte komunizëm, komunizmi duhet të ishte meqenëse si ideal është sublim por si praktikë polli totalitarizëm. Ndonëse komunizmi duhet të ishte, fatkeqësisht reale nuk ishte "komunizmi" në vetvete, jo se bëri pak si ideologji. Sepse bëri kushtetutën që në vetvete ligjëronte reprezaljet. Por katastrofën më të thellë në Shqipëri e ka bërë agjencura. Ç'do me thënë agjencura?

Domethënë njerëzit që kanë qenë të lidhur me shërbimet antishqiptare...

Ju mendoni që në Shqipërinë komuniste ku edhe miza që fluturonte kontrollohej, ka pasur një agjencurë të huaj që vepronte?

Sigurisht, se miza që fluturonte, nuk fluturonte kot.

Kush agjencurë? Cilat ishin agjencurat që vepronin në Shqipëri?

Ka qenë KGB-ja dhe UDB-ja. CIA ka dashur shumë të ketë nën kontroll situatën. Këto kanë ardhur prej Jaltës, kjo është rrjedhojë e Jaltës. Është logjike, po të fillojmë me formimin e partisë, të kalojmë me profilin e Hoxhës, etj mund të thuash shumë dhe kanë rëndësi historike për tu parë. Si detyrim i vendosjes gjeopolitike strategjike të vendit tonë, kjo çështje mbeti me doemos me pasojë. Por kanë pak rëndësi për temën tonë.

KGB-ja dhe UDB-ja ishin të pranishme në Shqipëri në nivele të larta apo jo?

Rezultojnë që ishin të pranishme në Shqipëri, në nivelet më të larta. Ju keni fakte për këtë, kush e thotë?

Faktet janë gjithçka që ka bërë Ramiz Alia dhe Nexhmija Hoxha.

Ju po thoni që Ramiz Alia dhe Nexhmija Hoxha ishin agjencurë e

KGB-së apo UDB-së.

Po ishin fitimtarët.

Çdo me thënë fitimtarët?

Domethënë pasi bënë të gjithë luftën për pushtet, pasi shkatërruan dhe vranë të gjithë pretendentët.

Pretendentët i vrau Enver Hoxha apo Ramiz Alia me Nexhmije Hoxhën?

I "vrau" Enver Hoxha sepse ishte ai në krye. Mund të ketë pasur edhe ndonjë firmë aty që në fund të fundit gjatë luftës për pushtet, kur i thua që ky njeri është i rrezikshëm e të tjera, vendimet janë të paracaktuara. Në parantezë, unë pashë filmin dhe kam qarë siç ka qarë çdo grua shqiptare, por këtu po analizojmë, t'i lëmë sentimentet.

Pra ju po thoni që Enver Hoxha përdorej për të eliminuar ata persona që...

Enver Hoxha nuk përdorej. Është fjalë e dobët, edhe Enver Hoxha për sytë e mi është shumë i fortë dhe ashtu ka dalë i fortë. Por Enver Hoxhës i jepej një informacion i gabuar. Dhe ky informacion i gabuar nuk ka qenë vetëm kur ai u izolua, sepse kur u izolua u bë absolutisht i kontrollueshëm. Dua të them që informacioni i gabuar i jepet çdo lideri nëpërmjet rrugëve institucionale. S'ka bashkëpunëtor që t'i flasë titullarit kryesor, në këtë rast diktatorit, që ky zhvillim që po bëjmë nuk po ecën. Por do t'i bëjë vetëm lëvdata euforike. Kjo është logjika në të gjithë botën.

Përse Nexhmije Hoxha duhet të ishte agjente e KGB-së apo Ramiz Alia i UDB-së, ata ishin drejtues shumë të lartë të regjimit komunist?

Ramiz Alia nuk e merrte kurrë pushtetin dhe Nexhmije Hoxha nuk e merrte kurrë pushtetin pasi të vdiste Enver Hoxha pa qenë të tillë.

Po e kishte përsa kohë Enver Hoxha ishte gjallë...

Po do të trajtohej nga Mehmet Shehu ashtu siç u trajtua Mehmet Shehu nga Enver Hoxha dua të them në emër të tij nga Kadri Hazbiu, Ramiz Alia e Nexhmije Hoxha.

Pra ju mendoni që Nexhmije Hoxha dhe Ramiz Alia kishin frikë nga Mehmet Shehu?

Padyshim.

Përse kishin frikë?

Sepse Mehmet Shehu ishte më i egri i të gjithëve.

Ishte i egër, por të gjithë mendojnë

se ai do të sillej mjaft mirë me familjen e Enver Hoxhës...

Kështu mendojnë të gjithë, por nuk mendonte Nexhmije Hoxha kështu.

Ju mendoni se Nexhmije Hoxha kishte realisht frikë nga Mehmet Shehu?

Nexhmije Hoxha kishte realisht shumë frikë nga Mehmet Shehu.

E shprehte këtë?

Familja e Mehmet Shehut është sjellë realisht shumë keq ndaj familjes sonë.

Si është sjellë keq?

Bënin dualizëm të hapur që nuk kishin pse, sepse fëmijët e Enver Hoxhës ishin shumë të thjeshtë. Silleshin thjeshtë, pavarësisht se kanë të tjera kusure në kurriz, por ishin të sjellshëm, nuk ishin vanitozë, nuk ushtronin pushtetin e të atit, kurse fëmijët e Mehmet Shehut ishin arrogantë, prepotentë edhe ndaj nesh, edhe ndaj familjes sonë ishin kërcënues. Nuk të përfillnin, kalonin përpara me makina, të fyenin, etj. me radhë.

Pra ndihet ky dualizëm në bllok. Kur ka filluar?

Ky dualizëm ndihet vetëm nga fëmijët e Mehmet Shehut dhe Fiqireti ndaj Nexhmije Hoxhës. Jo nga Mehmeti ndaj Enverit. Mehmet Shehu për mendimin tim, priste me durim të vdiste Enver Hoxha. Mehmet Shehu vetë nuk i ka bërë keq Enver Hoxhës. Ndaj për mendimin tim, Enver Hoxha, ka pasur shumë të drejtë të mërzhitej për Mehmet Shehun kur ai është vrarë.

Si është vrarë? Është vetëvrasë apo vrarë?

Është vrarë. Unë them që është vrarë, hollësisht nuk është as vendi dhe ato janë hipotetike.

Vrasjen e Mehmetit ju e nxirrni në analizë e sotme, apo e keni dyshuar që në momentin që ndodhi? Unë e kam ndjerë që është vrarë, sepse nuk mund të vetëvritet një burrë si ai, aq më tepër që Enver Hoxha e kish falur dhe herë tjetër.

Më pas në analizat që keni bërë, ju rezultoi i tillë...

Në të gjitha analizat ashtu më del. Me mërzhitjen e Enver Hoxhës ashtu më del. Me gëzimin e Nexhmijes ashtu më del, edhe të fëmijëve edhe me tablonë sinoptike ashtu më del. Sepse me tablonë sinoptike duhet të qetësonte Shqipërinë, njerëzit, sepse nuk është e kollajshme të vetëvritet një kryeministër, dhe duhet ta deklarojë spiun gjë që edhe mund ta ketë besuar. I KGB-së është, sepse e ka ditur vetë Enver Hoxha dhe e ka lejuar. Ai i dinte se kush është i KGB-së dhe kush jo, pra kë lejonte dhe kë jo.

Ju mendoni që Enver Hoxha e dinte se kush ishin spiunët e KGB-së?

Po. Po.

Dhe i toleronte?

Jo i toleronte, i linte në funksion, ua diktonte funksionin. Dhe në rastin e tablosë sinoptike, thotë që më ka dalë poliagjent. Pra më ka dalë edhe në anë tjetër që unë nuk e njoh. Domethënë më ka tradhtuar.

Ju mendoni që edhe midis drejtuesve të lartë të regjimit komunist kishte njerëz që punonin për KGB-në dhe UDB-në?

Po, është e domosdoshme, në çdo shtet kështu është.

Dhe këta njiheshin nga drejtuesit e lartë komunistë?

Enver Hoxha njihje ata që ju a dinte hapin. Ata që nuk i njihje po të bëheshin rrezik do t'i likuidonte. Do t'i likuidonte në emër të së vërtetës që ata ishin rrezik ose në emër të intrigës që ju thurej nga të tjerë që ata ishin rrezik.

Të gjitha këto eliminime që Enver Hoxha bënte, ndahen në dy pjesë;



eliminimet e atyre që quheshin kundërshtarë politikë, klasat e përmbysura që në një farë mënyre komunizmi u mori pushtetin dhe i ndëshkoi dhe eliminimet brenda kupolës drejtuese të Partisë Komuniste....

Enver Hoxha ka bërë reprezalje vetëm për luftën për pushtet. Luftën e klasave e kemi zhvilluar vetë, e ka zhvilluar shoqëria që është e molepsur nga agjuntura. Shqipëria ka kaluar nën vrotim, 1 në 3 veta do të ishte i sigurimit. Këtë se ka bërë Enver Hoxha dhe as e ka ditur ai.

Është e vërtetë kjo?

Po është e vërtetë, një në tre veta ishte bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit. Vëllai i gruas të vëllait tim, ishte një ndër ata. Dhe vëllai im vdiq 40 vjeç sepse ishte i pakënaqur me Ramiz Alinë pas vdekjes së Enver Hoxhës. E deklaroi këtë dhe për gjashtë muaj vdiq. Një histori e tillë, e ngatërruar me shumë intriga ndodhi edhe me time motër më vonë e cila vdiq por rreth 40 vjeç pikërisht kur do hapej publikisht. Të gjitha këto janë fakte që mua më kanë çuar në rrugën e studimit se çfarë ka ndodhur poshtë tek njerëzit e thjeshtë, pale ata të implikuarit biografikisht. Sepse mua mi bëri Nexhmija dhe Ramizi, dikujt tjetër ja ka bërë kryetari i...

Ju e ndjenit këtë dhunë që ushtrohej poshtë?

Nuk e kam ndjerë kurrë këtë dhunë që është ushtruar poshtë, e kam ndjerë vetëm në familjen e Enver Hoxhës, jam ngritur kundër saj, kam luftuar kundër saj. Duke mos e ditur, unë kërkoj ndjesë, pale pastaj që po ta dija nuk e di se çfarë do të ndodhte me mua se do të dilja kundër, por jo për luftë për pushtet. Ndaj nuk do të isha këtu, do të isha diku tjetër. Në librin tim, logjika e sistemit është analizuar shumë mirë, po gjithashtu nuk mjaftonte vetëm logjika e sistemit por duhej më tepër se kaq që Shqipëria të ishte ajo që ishte dhe të jetë ajo që është.

Është agjuntura që të ndante Shqipërinë, gjysmën Beogradit dhe gjysmën Greqisë. Fakte këto që sot dalin, sajë edhe studiuesve si Auron Tare, por edhe gjëra që dihen. Për sa i takon Enver Hoxhës, nuk të falte për pushtet. Por ama fali Sejfulla Malishovën, fali Kristo Frashërin, e të tjerë si ata. Shumë të persekutuar i kanë fëmijët nëpër shkolla sepse i kanë dërguar letër Enver Hoxhës dhe Enver Hoxha i ka toleruar. Unë vetë, jam martuar me Sokol Hoxhën, pasi ime motër mori nipin e armikut të popullit që ishte në burg. Pra Enver Hoxha toleronte.

Por ka eliminuar persona, që në gjykimin tim nuk e kërcënonin pushtetin e tij?

I janë paraqitur si të tillë në rrugë institucionale.

Po marr Beqir Ballukun, Petrit Dumen...

Unë personalisht këtë çështje e filloj me Beqir Ballukun...

Sepse në qoftë se Mehmet Shehu përbënte një kërcënim për familjen Hoxha, sipas Nexhmije Hoxhës, pjesa tjetër e tyre nuk kishte asnjë lloj problemi?

Unë e filloj me Beqir Ballukun sepse atëherë kam qenë dëshmitare, sapa isha martuar. E kam diskutuar këtë gjë madje me Enver Hoxhën. Nuk e gjykoja dot sa fajtor ishte Beqir Balluku, por thosha se çfarë keni me fëmijët edhe fisin. Përgjigja ishte shumë evazive po e pakontestueshme që këto gjëra kështu janë, mos u fut. Unë e besoj që Beqir Balluku është likuiduar nga të tjerë, nga Mehmet Shehu dhe pas kësaj atij do ti vinte radha sepse ai ishte më i fortë se Ramiz Alia kur u lidh prej krushqisë me Nexhmije Hoxhën.

Në eliminimet e Enver Hoxhës disa ngjallin pikëpyetje pavarësisht se kanë qenë njerëz të angazhuar apo kundërshtarë të tij, është nipi i tij, apo kushëriri Abaz Omari, Bahri Omari, një njeri që e kishte ndihmuar shumë madje në momentin e pushkatimit ka marrë edhe dhuratat nga Nexhmije Hoxha, dhe më pas Syrja Selko, i cili po ashtu e kishte ndihmuar. Përse kanë ndodhur këto eliminime? A i kishit dëgjuar ju në familjen e Hoxhës këto eliminime?

Atëherë jo. Këto i kam dëgjuar në '90-ën. Nuk i justifikoj, llahtarise.

Pra nuk flitej për Bahri Omarin në familje?

Jo, lihej të kuptohej nga vizitat që bënin të bijtë, që respektoheshin shumë nga Enver Hoxha, edhe ata e respektonin shumë, që burri i Faries është ekzekutuar. Edhe bindja ime ishte që

është ekzekutuar sepse ishte armik, ishte ballist. Se nuk ishte ashtu, këtë gjë e mora vesh pas vitit 90 dhe e kam thënë, diku, nderim për ata djem, të cilët të dyzuar midis të atit dhe Enverit arritën të kenë nderim për Enverin. Unë nuk do ta kisha bërë dot këtë gjë.

Po për rastin e Syrja Selkos apo Abaz Omarit, nuk përmendeshin fare?

Ata i kam dëgjuar nga ju, nga filmimet tuaja.

Ka mjaft komente që lidhen me atë që quhet trashëgimia e Enver Hoxhës, që ndahet në dy pjesë, atë që duhet trashëgimia kulturore, dokumentare dhe trashëgimia pasurore. Ku gjenden shumë prej dokumenteve origjinale të Enver Hoxhës, ditarët, shënimet e tij, kopje të të cilëve ndodhen sot në Arkivin e Shtetit të transferuara nga arkivi i tij personal në fondin e Komitetit Qendror. Ku gjenden origjinalet?

Origjinalet i ka Nexhmije Hoxha dhe Teuta për pasojë. Jo kot e kam quajtur Nexhmija 2 Teutën, jo për ilaritet, por ato funksione kishte marrë që në gjenezë, që kur u martua me Ilir Hoxhën. U martua me intriga të llahtarshme, intriga që asnjë vajzë 15-vjeçare nuk do ti mbante në kurriz.

Si mund të bëjë intriga një 15-vjeçare?

Epo ja që ajo i ka bërë. Në qoftë se duhet të verifikohet e vërteta ime, duhet të ndalen tashmë se vjen një ditë që thuhet të gjitha. Edhe unë nuk dua ti them të gjitha. Intriga të nënës së saj, një kartomante, një grua që merrej me stregonerira, një manipulatore. E kaluara e të emës së saj është shumë e diskutueshme. Kjo grua, e lidhur me Nexhmije Hoxhën që herët, çfarë nuk kanë bërë që e bija, vajza e saj të bëhej nusja e Ilir Hoxhës.

Po mund të jetë e drejta e çdo nëne që ta martojë vajzën e saj me djalin e kreut të shtetit...

Po, por jo medoemos të bëjnë presion tek autoritetet mjeksore që ata të pranojnë që është shtatzënë kur nuk është. Njerëzit janë gjallë dhe le ta kundërshtojnë. Le ta kundërshtojë Nexhmija edhe mjeku. Kështu janë këta njerëz. Kështu i kanë nisur fillesat e tyre.

Si kanë qenë raportet tuaja me nusen tjetër të familjes Hoxha? Ka pasur xhelozie mes jush?

Ka pasur deri obsesion, ishte e njëanshme, sepse s'mund të ishte e dyanshme. Duhet ta njohësh atë dhe kush e njeh le ta vlerësojë, le ta pëlqejë. Si e kam njohur, si jam llahtarisur prej saj, sa ka ardhur në shtëpinë e Enver Hoxhës, këto gjëra nuk i përkasin fushës së xhelozisë humane. Janë çështje pushteti që i delegonte Nexhmija që intuitivisht unë e kam ndjerë që në fillim. Unë prej saj vetëm jam ruajtur dhe kam thënë që një gjë kaq e trashë,

kaq e pashkolluar është shumë e rrezikshme sepse është në gjendje që të bëjë gjithçka e komanduar siç ishte.

Jeni e sigurt që nuk është motivi i një problemi xhelozie mes jush?

Po, në qoftë se është motivim xhelozie, fakti që në vitin 1990, ka qenë ndërlihdhëse e Ramiz Alisë dhe Nexhmije Hoxhës me Edi Ramën, Blendi Gonxhen dhe të ndjerin Ardian Klosi. Të cilët, i fuste në kurth nëpërmjet mënyrave femërore dhe i sulmonte më pas. Kjo ishte metodë jo vetëm e saj, por e diktuar dhe e njohur nga Ramizi dhe Nexhmija.

Ramiza Alia në fund të fundit e çoi në burg Nexhmije Hoxhën në mos gaboj në 1991?

Ramiz Alia e çoi në burg Nexhmije Hoxhën sepse u thye paksa gjasme varianti i Katovicës, që nuk ishte Katovicë e Gorbaçovit por ishte e Ramiz Alisë. Sepse Gorbaçovi, nuk bëri Katovicën që në rast nevojë ta kthente pushtetin me gjak dhe hekur, kurse Ramiz Alia e deklaroi që pushteti jonë është i sigurt dhe ne do ta kthejmë pushtetin me gjak dhe me hekur. Kështu që në burg e futi Nexhmijen vetëm për kafe siç futi edhe të tjerët moralisht jo politikisht. Edhe kjo i doli nga dora sepse ishte presioni i brendshëm sepse ishte Sali Berisha kryeministër. Sali Berisha, cilido të ketë qenë komunist i egër, apo ekstremist komunist, etj., ishte nën presionin nga poshtë, nga e djathta e mirëfilltë.

Çfarë ka ndodhur me trashëgiminë dokumentare të Enver Hoxhës? Besoni që i ka Nexhmije Hoxha? Keni fakte apo analizë?

Po po, i ka Nexhmije Hoxha. Ajo edhe për dokumentacionin tonë personal, letërkëmbimin me Enver Hoxhën na ka dhënë kopje, jo origjinalet. Originalin ia ka dhënë Ilirit dhe Teutës (trashëgimtarëve të pushtetit). Këtë e di, sepse ma tha vetë, se nuk kisha si ta dija. Edhe Pranverës i ka dhënë kopje, të gjitha të tjerat i ka mbajtur vetë edhe letërkëmbimin tonë, që nuk janë të rëndësishme, janë ditarë, letra.

A rrezikon zonja Hoxha të zhdukë, të shkatërrojë ose të dëmtojë materiale komprometuese, që mund të gjenden në arkiv por që kanë vlerë historike?

Për mua i ka zhdukur sepse ajo fshihet pas Enver Hoxhës, bën propagandë është dogmatike, aspak patriote, është gjoja konservatore marksiste leniniste. Por ndërkaq, në këtë formë ajo e degjeneron Enver Hoxhën, i cili që shumë më pak marksist-leninist se sa ishte nacionalist.

A ka pasur një trashëgimi financiare të Enver Hoxhës?

Nuk është e mundur të ketë pasur. Mund të ketë pasur trashëgimi shtetërore.

Kë quani ju shtetërore?

Shtetërore quaj fondin shtetëror. Një shtet ka fondin e vet, që sot ndodhet atje ku i ka çuar i biri i Ramiz Alisë, gjatë vizitës me të atin në Amerikë. Është në libër, se si ata e kanë transferuar fondin shtetëror, thesarin e shtetit në Amerikë dhe e zotërojnë për veten e tyre.

Fond i madh?

Nuk e di. Në këtë mes, Nexhmije Hoxhën e kanë nxjerrë jashtë. Nëse kishte kodin më parë, se ka më tani. Po pa gjë, nuk ka ngelur. E para paguhet nga UDB-ja dhe e dyta ka mënyrat e saj, pjesë tek DEKA.

Kjo është paksa mitologjike?

Mitologji, po qëndron aq sa qëndron parulla që: Deka është e djemve të Enverit. Nuk do të qëndrojë në qoftë se deklarohet që fëmijët e Enverit nuk kanë pjesë tek Deka. (Vijon në faqen 8)



(Vijon nga faqja 7)

Në qoftë se jo, ata që kanë pjesë tek Deka janë Nexhmija me fëmijët e tjerë. Kjo nuk është mitologji, është fakt.

Deka ka pronarë, dihet kush e ka... Është çështje aksionesh, që nuk mund të dihet asnjëherë.

A ka pasur pasuri familja Hoxha në fund të viteve '90?

Familja Hoxha, Enver Hoxha, nuk kishite si të kishite pasuri. Ai nuk e njihite lekun, nuk ka mbajtur ndonjëherë lekë në duar apo në xhepa. Ka qenë një kohë madje që më ka thënë, Liliana mblidhni lekë se nuk i dihet jetës.

Kur jua ka thënë këtë?

Vitet e fundit të jetës.

Por ndërkohë, sipas burimeve që ne jemi ende duke i verifikuar, por nuk i konfirmojmë deri më sot, në familjen e Enver Hoxhës, disponoheshin mjaft bizhuteri, me vlerë të madhe të konfiskuara në vitet '44, '45, '46 nga ato që quheshin klasa të përmbytura, bejlerë, pasanikë të mëdhenj, biznesmenë, që nuk janë regjistruar në pasurinë shtetërore. Nëse del e vërtetë, mbetet për t'u verifikuar...

Përrjashtoj faktin që të jenë të Enver Hoxhës. Nuk e përjashtoj faktin të jenë të Nexhmijes dhe të vajzës dhe nuses, sepse edhe ua kam parë në duar, unaza shumë të vyera në atë kohë, që nuk i kishte njeri. Edhe vetë Enver Hoxha i ka kritikuar duke u dhënë shembullin tim me duar të pastolisura. Sot e kam edhe unë një, disa madje jo aq të vyera mundësuar prej fëmijëve të mi, se sot erdhi koha për të tërë.

Po juve nuk ju ra në sy?

Më binin në sy dhe nuk e dija nga i kishin.

Dhe nuk i kishit pyetur kurrë?

Nuk i pyesja sepse nuk kishim atë marrëdhënie, nuk flisnim midis nesh. Por dhe nuk do e gjeja kurrë të vërtetën. Por më bëri shumë përshtypje sjellja e Nexhmijes tek Bugajski, kur thoshte: pse s'dija unë që të mbuloheha me ar, të vija gjerdan etj. Më ka bërë përshtypje sepse mentalitetin e gruas së Enver Hoxhës (ashtu siç duhej të ishte ajo), nuk mund të vlonte dëshira, apo të ndjehej e pangopur për gjerdanë e për unaza. Dëshira për ti pasur ishte absurde. Ish-te për të qeshur ta dëgjoje.

Pra ju nuk keni dëgjuar kurrë për këtë histori, për bizhu që ishin në pronësi...

Unë i kam parë bizhutë në duart e gruas së Ilirit sidomos, edhe të Pranverës. Për vete kam pasur ndonjë gjë të vogël që ma sillte Sokoli kur ikte jashtë shtetit.

Cila është trashëgimia financiare e Hoxhës, zero?

Jo e Enver Hoxhës, e Nexhmije Hoxhës. Së pari, Enver Hoxha ka vdekur, së dyti ai nuk ishte i interesuar për këto gjëra. Por di dhuratat që u kanë ardhur nga kryetarë shtetesh si Sihanuk, etj., që janë objekte me vlerë.

A ka qenë realisht Nexhmije Hoxha e papërfillshme nga Enver Hoxha në atë që quhej drejtim i shtetit?

Deri në vitin 1973 ajo ka qenë një grua intelektuale për hesap të saj dhe kaq. Me sëmundjen e Enver Hoxhës, teksa kontrollonte shëndetin e tij, ajo u bë gjithnjë e më e fuqishme si transmetuese, fillimisht. Më vonë nuk mund ta thuash se çfarë bënte nëpërmjet transmetimit. Unë këtu kam sjellë, edhe është e vetmja fotografi që unë po sjell vetë (sepse çdo foto tjetër është prej medias), është një fotografi ku Nexhmije Hoxha flet në telefon, në kohën që Enver Hoxha rri normalisht. Praktikisht ajo po transmeton orientimin me këtë telefon.

Po mund të flasë në telefon, çfarë problemi ka?

Ky telefon është i lidhur drejtpërsëdrejti me Komitetin Qendror.



Pse kishte një telefon direkt të lidhur me Komitetin Qendror?

Po ishte i lidhur direkt. Telefoni për shëpinë, familjen, ishte i brendshëm. Pra nuk është duke folur me familjen. Nuk po flet as me punën e saj, se s'mund të flasë në prani të Enver Hoxhës çështjet e saj. Në prani të Enver Hoxhës do të fliste vetëm me urdhrin e tij. Është një telefon special. Kjo fotografi vërtetohet që me izolimin e Enver Hoxhës, Nexhmije Hoxha të paktën bëhet transmetuese. Pastaj gjatë transmetimit se si evoluon roli i saj në fildër për të sjellë informacionin ashtu siç e do.

Po në fund të fundit, informacionin e bashkëshortit të saj përcillte apo jo?

Informacioni vjen ngafushate e Shqipërisë, është informacioni i Shqipërisë. Informacioni është ai që çoi në tufëzimin. Tufëzimin e ka bërë Instituti i Studimeve Marksiste Leniniste ku kjo ishte drejtore. E ka bërë Harilla Papajorgji sipas modelit sovjetik, e ka aprovuar kjo bashkë me Ramiz Alinë.

Kjo është një përgjegjësi direkt e Enver Hoxhës. Vendimet për tufëzimin janë marrë prej tij, ai ishte drejtues i shtetit...

Ia kanë ofruar si zgjidhje. Tufëzimin ai nuk e njihite si ekzistencë në qoftë se nuk i është prezantuar si zgjidhje të domosdoshme, se kështu shkon mirë ekonomia në fshat, afrohet me standardin e qytetit, etj. Ai deri në fund edhe para vdekjes ka thënë që, çfarë kemi bërë me tufëzimin dhe a është e mundur që të jetojë një fshatar pa një lopë, pa një pulë, etj. Kjo foto, është vetëm sinjal i problemit që rreth Enver Hoxhës, filloi filtri në vajtje dhe në ardhje. Kjo është e vërteta. Se si e gjykon cilido, nuk ka rëndësi. Enver Hoxha dhe i izoluar e kuptoi izolimin e Shqipërisë deri në atë pikë sa në 1982, ai bëri hapjen edhe ideologjike. Të lëshohej ideologjike domethënë ka lëshuar gjithçka. Në 1982, bëri marrëveshjen me Shtrausin, gjë që u pengua gjithçka nga Nexhmije Hoxha dhe Ramiz Alia. U pengua nga ky telefon.

Po pse duhet ta pengonin?

U pengua që të mbanin pushtetin nën urdhrin e UDB që Shqipëria të mbetej e dobët si kafshatë për tu kapërdirë. Ndryshe nuk mund ta mbanin pushtetin. Po të hapej e zhvillohej Shqipëria, do të dilnin të rinj, udhëheqje e re, progresiste me nivelin dhe inteligjencën sipas arsimimit brilant popullor. Sepse është Nexhmije Hoxha dhe Ramiz Alia që kanë mbajtur atë byro aq mediokre, që ta shtypnin.

Në mes të viteve '80 para vdekjes së Enver Hoxhës, ju e dinit nivelin e Byrosë Politike?

Unë jam këtu tek ju dhe dëshmoj, që Enver Hoxha më ka bërë titull për të tretën herë, një herë më tha normalisht, të dytën po ashtu, të tretën më bërtiti, se përse nuk më jep kandidatura për Komitetin Qendror të Rinisë dhe më pas kërkonte për Komitetin Qendror të Partisë. Kjo byro nuk i përgjigjet nivelit të vendit tonë thoshte, nivelit të shkollimit.

Përse ishte përzgjedhur kjo Byro Politike? Përgjegjësia në fund të fundit, ishte sërish e tija...

Atij i vinin me listë ky dhe ky me këto karakteristika "brilante". E thashë, siç u bënë vrasjet ashtu bëheshin edhe zgjedhjet e anëtarëve të Byrosë.

A flitej për vrasjet në familjen tuaj? Jo nuk flitej.

A kishit ju bindjen se këta kishin kërcënuar pushtetin dhe ishin tradhtarë?

Po ashtu besoja.

A kishit keqardhje për këto viktima? Padyshim.

Po për fëmijët e tyre me të cilët në një farë mënyrë kishit pasur lidhje? Unë nuk kam pasur lidhje me asnjë njeri. Por nuk mund ta pranoja, e nuk e gëlltisja dot si mungesë principi njerëzor.

Që në atë kohë?

Padyshim. Fjala është për në atë kohë, se sot të gjithë e thonë. Sot i vjen keq edhe Nexhmije Hoxhës.

Nuk ka shprehur keqardhje as në intervistën e fundit. Në eliminimet a ka rol Nexhmije Hoxha?

Unë them që ka rol vetëm Nexhmije Hoxha. Shiko, ju keni shkruar me stilin e Montefiores, por Enveri nuk ishte Stalin. Ishte stalinist, sepse Stalini e mbrojti për Kosovën. Enveri në qoftë se do ta njihite Stalinin siç njihet sot ai do të kishite korrigjuar shumë gjëra. Enver Hoxha ishte ndryshe. Nuk ishte Stalin. Nuk njihite orgji-dashuri-urrejtje dhe pastaj gjakderdhje. Ishte shumë i kontrolluar, i matur, serioz dhe shumë i ekuilibruar dhe me jetën e tij. Nuk po flas, që e kam shoqëruar në mbledhje, por në shtëpi. Gjithçka e ka bërë Nexhmije Hoxha së bashku me Ramiz Alinë.

Po si mund ta bëjë një grua këtë?

Në emër të Enver Hoxhës. Është përdorur Enver Hoxha.

Po flisni gjithnjë pas sëmundjes?

Po pas sëmundjes, që në 1972.

Po në bisedat familjare, a insistonte për ta bindur?

Jo, jo. Ajo ishte inekzistente, nuk fliste,

vetëm dëgjonte. Unë vetë mund të kem folur, apo ngritur ndonjë problem të vogël. Ai i thoshte: çohu dhe zgjidhe! Ajo ngruhej shkonte tek telefoni jo pranë tij, në dhomën tjetër. Nuk e zgjidhte dhe unë nuk mund ti thosha Enverit që Nexhmija nuk e zgjidhi problemin.

Keni biseduar ndonjëherë me Enverin për Nexhmijen? Kishte xhelozitë mes jush dhe zonjës Hoxha?

Xhelozitë? Jo xhelozitë jo. Unë kam të drejtën e të gjithë botës, por nuk arrij të urrej, nuk e njoh urrejtjen. Ndoshta do të ishte mirë, sepse urrejtja është ndjenjë shumë e fortë, e të çon përpara ndonjë jo moralisht. Por unë kam frikë nga Nexhmije Hoxha.

Frikë?

Po frikë për atë që është. Edhe unë nga frika e kam bërë atë libër. Nga frika se Nexhmije Hoxha është ajo që mund të bëjë gjithçka, bashkë me Ramiz Alinë. Ka bërë gjithçka në këtë vend.

Po Ramiz Alia nuk jeton më...

Nuk jeton më, por disa muaj ka që ka vdekur.

Çfarë mund të bëjë Nexhmije Hoxha, një grua 90-vjeçare, e vetmuar?

Po flasim për xhelozitë. Të ishte për karakterin tim për këto pyetje unë do të ngrihesha e do të ikja. Por kam ardhur të sqaroj opinionin shqiptar, ndaj dhe të përballim. Ju po flisni për xhelozitë, e unë do flas për fillimet e mia, jo tani. Pikërisht se Nexhmije Hoxha nuk më ka dashur kurrë, pikërisht se Nexhmije Hoxha më ka vranë vëllanë, më ka vranë motrën, ka vranë gjithë shqiptarët, ata që janë vranë e persekutuar vetëm për pushtetin e saj, unë atë grua e kam frikë.

E keni ende frikë?

Jo atë si person por dukurinë. Bën Nexhmija e dytë ndonjë përgjigje në shtyp, që nuk ka lekë të blejë shtëpi se është e varfër, po ato janë të pabesueshme. Kjo tregon që fenomeni vazhdon. Sepse kanë ato bizhuteri që thate ju, që unë i kam parë me kohë. Në vitet 90, Pranvera thoshte kam dollarë, kurse unë, fëmijët e mi dhe Sokoli nuk kishim të hanim. Po ta lëmë me kaq. Kështu që unë nga ajo grua kam pasur frikë që ditën që e kam parë, që ditën që shkova në Komitetin Qendror ku e kam njohur për herë të parë.

Ku e keni njohur për herë të parë?

Në vitin 1972.

Përse vajtë në Komitet Qendror?

Sepse unë duhet të ndahesha nga Sokoli sepse thashë nuk dua, nuk më pëlqen atmosfera këtu. Jo Sokoli, se ai më pëlqente shumë, por jetesa në bllok, kisha shumë paqartësi, nuk ndihesha mirë. Nuk desha. Më kishte thënë edhe im atë, që djali i Enverit është i mrekullueshëm, por unë nuk mund të lejoj që vajza ime të dalë me të. Kaq më duhej.

Dhe ju shkuat të takonit Nexhmije Hoxhën?

Unë e "lashë" në fakt Sokolin dhe ai vajti me vrap në familje dhe tha që Liliana më la. Urgjentisht brenda javës ajo më kërkoi në zyrë për të legjitimuar njohjen zyrtare.

Dhe si ka qenë takimi juaj i parë me të?

Kam zbritur e frikësuar. Kam vajtur në shtëpi e frikësuar, më e torturuar se më parë, ta lë apo mos ta lë Sokolin.

Përse?

Se ishten një grua e tmerrshme, e frikshme. Ka qenë gjatë gjithë jetës sime e frikshme.

Ka qenë vetëm me ju apo dhe me të tjerët?

Unë mendoj që ka qenë me cilindo që ajo ndihet e kërcënuar. Në familje ka qenë e kërcënuar prej meje. Ajo nuk është e keqe me mua, ajo është grua e tmerrshme. Nuk ka grua të dytë si ajo.

Po ka qenë shumë e devotshme me Enver Hoxhën?

Absolutisht jo e devotshme. Në dukje e devotshme. Ka qenë e frikshme në devotshmërinë e saj sepse devotshmëria e saj ka qenë kontroll nuk ka qenë kujdes hu-

man.

Sot ju thatë që keni parë edhe filmin që unë bëra, keni thënë se keni lënë përgjysmë librin sepse jeni ndërjerë keq. Vazhdoni pas të gjithë kësaj, ta vlerësoni ende Enver Hoxhën ju personalisht?

Unë nuk e vlerësoj Enver Hoxhën absolutisht në rrugë personale. Por në kuptimin se si duhet ta vlerësojë Enver Hoxhën një qytetar. Por unë e njoha Enver Hoxhën, dhe derisa njoha nuk kam çfarë të bëj. Në rastin e vrasjeve unë Enver Hoxhën, e kthej përmbys dhe nuk e justifikoj me gjithë legjislaturën që ia lejonte ato.

Por vazhdoni ta admironi si person?

Po. Them që dhe është punuar, që të mos ndalemi tek arsimi, shëndetësia, siguria, kjo e ajo se ato dihen. Ju keni kapur një aspekt dhe në këtë aspekt keni punuar shumë mirë. Unë ju uroj. Do të ketë të tjera punime, ai njeri ka qenë nacionalist. Përpos komunist, nacionalizmit ai i ka qëndruar më së miri, sidomos në fund.

Ai tha të vendoset feja se e kërkoi Shtrausi, të bëhen lëshime ideologjike, të bëhet çdo gjë që Shqipëria të hapet. Për Kosovën bëri shumë, gjë që Nexhmije Hoxha e shpreh ndryshe në formën që do. Do të thosha që sot akoma Kosova vuan për vetëvendosje dhe prandaj Albin Kurti i drejtohet qeverisë tonë të sotme që të ndërhyjë në OKB për ta ndihmuar, sepse akoma Kosova sot me fusnotën është përsëri e pushtuar. Ashtu siç jemi edhe ne të paorientuar, të ç'legjitimuar në substancën tonë kombëtare prej dy partive kryesore. Hap kutitë, mbyll kutitë, shko në parlament, mos shko në parlament. Bëj këtë se e kërkojnë Amerikanët, bëj këtë se kërkon Evropa, kur dhe Evropa dhe Amerika kanë filluar të lodhen me ne dhe thonë bëni ç'të doni vetëm mos u zini. Kështu që ne brenda nesh, ngelemi të sëmurë, shumë keq. Kjo gjë, mund të shërohet vetëm prej vetes tonë, siç po shërohet Turqia që ka guxim të kërkojë të hyjë në Evropë me neo-otomaninë, që do të thotë se nuk kanë qëllim ekspansiv, por që kanë qëllim ngritje ndërgjegjeje kombëtare, krenari kombëtare. Ne nuk kemi krenari sepse këtë krenari na e kanë shtypur agjenturat me protagonistë përkatës që përmendëm. Se kanë shtypur emrin e Enverit, dhe e kanë shtypur pikërisht për të shtypur ndërgjegjen kombëtare. Për mua Enver Hoxha është ndërgjegjja kombëtare.

Mbas shfaqjes së një filmi mjaft interesant dhe me shumë çmime "Albanian divorce style" që flet për atë që pëson gratë e bllokut komunist, që ishin martuar në Shqipëri, ruse, polake, etj., ju reaguat publikisht dhe kërkuar ndjesë dhe shprehët keqardhjen tuaj. Si shpjegohet që vetëm ju, e pak të tjerë shprehët keqardhje, dhe shumë prej drejtuesve të tjerë nuk shprehin keqardhje? Vetë zonja Hoxha madje, në intervistë nuk shprehu asnjë keqardhje ndaj viktimave, madje u shpreh se shumë prej atyre që janë dënuar kanë qenë hajdutë ordin-

erë...

Jo tha edhe një gjë më të tmerrshme, se aty flet kot ajo. Puna është se duke kundërshtuar gjoja të sotmen, duke aluduar kundër qeverisë tha: kujt t'i kërkoj të falur, këtë gjë nuk po ma kërkon populli. Së pari, nuk ka ndjenjen e përgjegjesisë, të vetëvuajtjes, kurse në raport me të tjerët nuk ka pasur dhe nuk ka absolutisht ndjeshmëri humane. Pastaj përpara konceptit popull është për t'u ndalur edhe për të ardhur keq. Kush na ka udhëhequr që atëherë e deri më sot.

Nuk ka shprehur asnjëherë keqardhje askush tjetër?

Nga familja po thoni... Sokoli është me mua.

Shtohet numri i sipërmarrjeve, më pak ato që mbyllen

QKR: Janar-prill, u hapën 5824 biznese të reja



Eglantina Nasi

eglantinanasi@kohajone.com

Bizneset e reja që po hapen në Shqipëri, përveçse janë më të shumta se ato që mbyllen, po figurojnë në rritje edhe nga viti në vit. Ky përfundim del nga të dhënat më të fundit të publikuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimeve (QKR), sipas të cilave, vetëm në katër muajt e parë të këtij viti numërohen 5824 biznese të reja të hapura. Kujtojmë këtu, se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, kjo shifër ka qenë vetëm 5566 të tilla. I bie në këtë mënyrë, që gjatë muajve janar-prill 2012, të jenë

5566

Biznese të reja të hapura rezultojnë, sipas Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve, gjatë katër muajve të parë të vitit të kaluar

regjistruar saktësisht 258 biznese më shumë, me një rritje vjetore në nivelin prej 4.6%. Nga ana e tij, në një prononcim për mediat, nëndrejtori i institucionit të QKR-së, Raimond Cimbi, është shprehur se prirja e regjistrimeve është më

4.6%

Rezultoni rritja e bizneseve të hapura gjatë katër muajve të parë të këtij viti, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar

e lartë, krahasuar me prirjen e regjistrimeve. Në këtë kuadër, mendohet që të ketë ndikuar kthimi i një mase të konsiderueshme të emigrantëve shqiptarë nga Greqia, të cilët kanë preferuar të ngrenë sipërmarrje në vendin e



tyre. E parë në këtë këndvështrim, duket se kriza ekonomike financiare që ka përfshirë vendet e rajonit, nuk ka ndikuar negativisht në Shqipëri, lidhur me treguesin e nxitjes së sipërmarrjeve të lira. E këtë dukuri, përveçse e kanë theksuar shumë raporte ndërkombëtare, së fundmi e vërtetojnë edhe shifrat e ofruara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimeve për ecurinë e hapjes së bizneseve të reja në vendin tonë. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i këtij institucioni, ka përmendur faktin, se një numër i konsiderueshëm i sipërmarrësve që kanë hapur një biznes të ri në vendin tonë gjatë 4 muajve të parë të këtij viti, kanë qenë të huaj. Një tjetër fakt, ky që flet për tërheqjen e investitorëve nga jashtë drejt vendit tonë. Dukuri kjo e cila është

të shpjeguar nga autoritetet e larta shqiptare, me efektin pozitiv të reformave të ndërmarra nga qeveria në kuadrin fiskal dhe atë të ekonomisë vendase në tërësi. Kujtojmë se ligji i ri për reformën në regjistrimin e biznesit, ka hyrë në fuqi në vitin 2007 dhe parashikonte themelimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një institucion të ri publik në nivel qendror. Kjo reformë u interpretua edhe nga institucionet e huaja ndërkombëtare si një hap domethënës në programin e qeverisë për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri. E kjo falë disa përfitimeve të rëndësishme që ajo ofron, si për bizneset shqiptare, edhe për investitorët e huaj, e cila po reflektohet edhe me rritjen nga viti në vit, i regjistrimeve të reja të tyre.

AMC mbështet artistët e rinj në konkursin e FAP

AMC dha mbështetjen e saj në konkursin e Portretit Psikologjik, zhvilluar në Galerinë e Akademisë së Arteve - FAP. Ky konkurs ishte pjesë e aktivitetit "ATELIE 2012", ku morën pjesë mbi 30 artistë të rinj, studentë të vitit të parë të Fakultetit të Arteve të Bukura. Konkursi, i pari i këtij lloji, ishte konceptuar në pikturë, grafikë dhe skulpturë. Ky konkurs është vlerësuar si i një rëndësie të veçantë për faktin se u jep shtysë artistëve të rinj të angazhohen dhe të promovojnë punët e tyre. Përfaqësues të AMC dhe drejtues të Fakultetit të Arteve të Bukura dhe të Akademisë, ndanë çmimet për fituesit e përzgjedhur,



sipas punëve të tyre. Çmimi i parë shkoi për Florinda Markun, i dyti për Mirjana Mecaj dhe i treti për Hajredin Manuka. Kjo mbështetje u realizua në kuadër të kujdesit që AMC tregon për përkrahjen e artistëve të rinj, si dhe promovimin e artit dhe kulturës në Shqipëri.

Everest, alpinistët shqiptarë në 7100 m lartësi

Siç shihet edhe në foto, marshimi i guximshëm i alpinistëve shqiptarë për të arritur majën më të lartë të botës vazhdon dhe aktualisht ata ndodhen në lartësinë prej 7100 m. Pas 2 ditëve ecje aklimatizuese, alpinistët janë aktualisht në kampin bazë, pasi për datat 13-17 maj parashikohen era të forta që e bëjnë të pamundur ngjitjen. Ekipi është në gjendje shumë të mirë shëndetësore dhe do të vijojë marshimin, me qëllimin për të arritur majën më të lartë të botës prej 8848 metra në datat 20-25 maj. Kjo iniciativë e mbështetur nga Vodafone Albania dhe Raiffeisen Bank dhe e ndër-



marr nga 6 alpinistët tanë të guximshëm vjen si dhuratë për 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe pritjet që për pak ditë flamuri shqiptar të valëvitet në ballkonin më të lartë të Himalajave, Everest.

Instituti Botëror i Bankave të Kursimeve (WSBI) zgjedh Bordin e ri Drejtues

Një bankë shqiptare bëhet për herë të parë, pjesë e Bordit të WSBI

Marrakesh, Marok - Instituti Botëror i Bankave të Kursimeve (WSBI) ka zgjedhur Bordin e ri Drejtues të tij gjatë Mbledhjes së 19 të Asamblesë së Përgjithshme që u zhvillua në Marrakesh të Marokut. Bordi i ri Drejtues, me mandat nga viti 2012 deri në vitin 2015, përbëhet nga përfaqësues të ndryshëm të Grupeve Rajonale të WSBI-së që përfshijnë Europën, Amerikën Latine/Karibet, Azinë/Paqësorin dhe Afrikën. Për herë të parë në historinë e kësaj organizate prestigjioze, mes shtatë përfaqësuesve të tjerë europianë, si Gjermania, Spanja, Franca, Italia, Malta, Portugalia dhe Luksemburgu, përfaqësues nga një bankë shqiptare, Z. Mehmet Usta, Kryetar i Bordit Drejtues të BKT-së dhe Z. Seyhan Pencabligil, Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Bordit Drejtues të BKT-së, janë zgjedhur respektivisht si Anëtar dhe Anëtar i Alternuar i Bordit Drejtues të WSBI-së. WSBI, me qendër në Bruksel, bashkëpunon ngushtësisht me institucione ndërkombëtare financiare dhe përfaqëson interesat e anëtarëve të saj në nivel ndërkombëtar. WSBI është institucioni ndërkombëtar i bankingut individual që përbëhet nga 110 banka dhe shoqata të ndryshme nga 89 vende të ndryshme të botës, të cilat janë angazhuar në "3 R"-të e bankingut: Individual (Retail); fokusi kryesor i tyre janë individët, SME-të dhe/ose

Përfaqësimi

BKT, e cila u anëtarësua në WSBI më 21 shtator 2009, duke qenë anëtar i vetëm nga Shqipëria mban edhe detyrën si Koordinator Kombëtar. Përfaqësimi në Bordin Drejtues të kësaj organizate kaq të rëndësishme me Kryetarin e Bordit Drejtues dhe Drejtorin e Përgjithshëm dhe Anëtarin e Bordit Drejtues të saj, konfirmon rrugën e duhur që po ndjek BKT në drejtim të shërbimit me cilësi të lartë, risive teknologjike, zgjerimit, stabilitetit financiar dhe përfitueshmërisë. BKT gjithashtu është vlerësuar si "Banka më e mirë e vitit 2011 në Shqipëri" nga revista prestigjioze britanike "The Banker".

autoritetet lokale. Rajonal: lejojnë akses në shërbimet financiare nëpërmjet një rrjeti të gjerë pikash. I përgjegjshëm (Responsible): demonstrojnë përgjegjshmëri si në qasjen e biznesit ashtu edhe ndaj shoqërisë ku operojnë.

Dhoma e Tregtisë reagon ndaj ndryshimit të kryer në ligj

Biznesi: Tatimi mbi të ardhurat, na penalizon



Eglantina Nasi

eglantinanasi@kohajone.com

Parapagimi në çdo 3 muaj i tatim-fitimit përbën një kosto shtesë dhe të palogjishme, e cila do ta vendosë në shumë vështirësi financiare biznesin". Me një deklaratë të tillë, kreu i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, Nikolin Jaka, ka shpjeguar ndikimin që sipas tij do të kenë tek sipërmarrjet shqiptare ndryshimet e fundit të kryera në ligjin "Për Tatimin mbi të ardhurat". I hartuar plot 14 vjet më parë, ligji nr. 8438, i datës 28.12.1998, iu ndryshua pikërisht nën 30 i tij, duke parashikuar që ai të parapaguhet i ndarë me këste katër herë në vit, siç i bie konkretisht çdo tremujor. Dhe një gjë e tillë, sipas Jakës, do ta shtrëngojë biznesin, të rrisë me tej kostot e tij. "Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan në llogarinë e organeve tatimore, këste tre-mujore të tatimit mbi fitimin, jo më vonë se



Kreu i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, Nikolin Jaka

data 15 e muajit janar, prill, korrik dhe tetor", parashikon konkretisht ndryshimi në ligjin e lartpërmendur. Por i komentuar nga ana e biznesit, miratimi i këtij ndryshimi "të papritur, do të thotë se

atij i duhet të parapaguajë "të paktën trefish të shumës që shlyejnë sot çdo muaj për tatimin mbi fitimin". "Shumë kompani do të vihen në pamundësi për ta parapaguar trefishin e shumës që

shlyejnë sot për tatim fitimin dhe do të ketë shumë raste gjobash për mos-shlyerje, gjë e cila do të rëndojë edhe më shumë gjendjen financiare të kompanive, duke rritur edhe presionin psikologjik negative mbi to", - tha më tej Jaka, lidhur me argumentimet që jep biznesi kundër aplikimit të një mase të tillë. Sipas tij, duke mos njohur ende gjendjen përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve për tre muajt në vijim, sipërmarrjet shqiptare mund të ndihen në presion për shumën e tatimit të fitimit që duhet paguajë pas 3 muajsh. Nga ana tjetër, kreu i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, pohoi faktin se ky institucion po harton një platformë të posaçme të cilën do t'ia paraqesë ministrisë së Financave për të likuiduar ato kompani që shteti u ka borxhe. Ndërsa ndryshimet në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat" pritet të diskutohen edhe pas dy ditësh në mbledhjen e radhës së Këshillit Konsultativ të Biznesit, ku ky i fundit pritet që të ngrejë shqetësimet e lartpërmendura.

MF: Ndryshimet, si politikë e re fiskale

Në pozicionin e propozueses së ndryshimeve në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", ministria e Financave ka shpjeguar se synimi i tyre "është pikërisht vendosja e një politike të re fiskale lidhur me parapagimin e kësteve të këtij tatimi". "Arsyeja kryesore e propozimit lidhet me përmirësimin e indikatorëve të Shqipërisë në raportet e Bankës Botërore "Doing Business", - thuhet në relacionin përkatës të MF-së. Duke shtuar se pjesa më e madhe e vendeve kërkojnë pagesën e kësteve në mënyrë periodike, zakonisht në bazë 3-mujore, gjatë vitit fiskal, të cilat më pas kreditohen kundrejt detyrimit final në momentin që kypërcaktohet në bazë të deklaratave tatimore vjetore. "Një sistem pagesash paraprake i konceptuar mirë normalisht do t'i llogariste pagesat sa më afër që të ishte e mundur me detyrimin aktual vjetor. Kjo do të shmangte nevojën për pagesa të mëdha tatimesh në fund të vitit që mund të ishin problematike për t'u vjelë dhe do të shmangte nevojën për rimbursimet e rezultuara nga mbipagesat", argumentojnë më tej ekspertët e ministrisë së Financave.

BE: Greqia të qëndrojë në Eurozonë

Greqia duhet të qëndrojë në Eurozonë dhe do të bëjmë gjithçka që ta arrijmë këtë rezultat. Ky ka qenë mesazhi i lançar zyrarisht gjatë takimit të ministrave të Financave të Eurozonës, mbi zhvillimet në vendin ballkanik që gjendet në një krizë të thellë financiare. Nga ana e tij, mësohet se ministri gjerman i Financave, Shobler ka shpjeguar se asgjë nuk ka ndryshuar kundrejt nevojave të Greqisë për miratimin e reformave ekonomike. Ndërsa ministrja austriake, Maria Fekter, mësohet të jetë shprehur se Greqia nuk mund të dalë nga Eurozona, por mund të braktisë Bashkimin Evropian, e në këtë mënyrë edhe monedhën Euro. Ajo rikujtoi madje se traktati i anëtarësimit, e parashikon një gjë të tillë. Por kancelarja Angela Merkel, duket se e ka moderuar disi qëndrimin e saj, duke deklaruar se është më mirë gjithsesi, për të gjithë anëtarët, që Greqia të qëndrojë në Eurozonë. Në fund, ka qenë komisioneri për çështjet ekonomike dhe monetare në BE, Olli Rehn, i cili ka dhënë qëndrimin e tij lidhur me këtë çështje, duke pohuar se "tashmë më shumë se kurrë është përgjegjësia e politikanëve grekë për të respektuar paktin me Bashkimin Evropian".

SPITALI HYGEA

Kanceri, kurim nëpërmjet Akseleratorit Linear

Rritja e rasteve të të prekurve me kancer në vendin tonë kashuar edhe domosdoshmërinë e terapive kuruese dhe aparaturave. Kështu një pjesë e mirë e pacientëve zgjidhjen për kurimin e sëmundjes e kanë gjetur nëpërmjet aparaturës së Akseleratorit Linear, aparaturë kjo që "bombardon" qelizat e prekura nga sëmundja. Prej më shumë se dy vjetësh, pacientët në vendin tonë e kanë gjetur këtë zgjidhje në Spitalin Hygea, i cili është i pari institucion privat dhe i vetëm deri më tani në vendin tonë, i cili ofron këtë shërbim

nëpërmjet Akseleratorit Linear. Kurimi përmes Radioterapisë kryhet duke ruajtur më së miri organet jetësore gjatë trajtimit të larinksit, gjirit, fshikëzës së urinës dhe një numri të karcinomave të tjera. Për këtë qëllim, në Spitalin Hygea Tiranë, Radioterapia dhe Departamenti i Onkologjisë, në përdorin teknologjinë më moderne të radioterapisë me konformitetit 3D dhe intensitet të moduluar 3D. Kanceri përfaqëson shkakun e dytë në renditjen e vdekjeve në rang ndërkombëtar pas sëmundjeve të zemrës. Dhe për t'u ardhur në ndihmë të gjithë këtyre rasteve, vetëm pak ditë më parë ka qenë Drejtoresha Rajonale e OBSH-së, Suzanë Jakab, e cila ka vënë tullën e parë të bunkerit ku do të vendoset akseleratori linear në sistemin publik, pikërisht në Pavijonin e Neurokirurgjisë në QSUT.



RIKTHEHET

Nga 19 Maji

Çdo ditë, nga e Hëna në të Premte, faqet "Summer Time" dhe çdo të Shtunë e të Diel, suplementi "Summer Time"

Falas, me gazetën "Koha Jonë"



17.63

Për qind më pak paguhen femrat në vendin tonë në krahasim me meshkujt, pavarësisht se numri i tyre që diplomohen në universitete është disa herë më i lartë

21.5

Për qind është papunësia e grave aktualisht nga 18.2 për qind në vitin 2007. Ndërkohë që pjesëmarrja e meshkujve në tregun e punës ka mbetur pothuajse e qëndrueshme.

76.2

Për qind e të punësuarave gra janë kryesisht në shëndetësi dhe punë sociale. Në arsim dhe bujqësi ato përbëjnë më shumë se gjysmën e punonjësve të regjistruar në këtë raport

1.5

Fëmijë është mesatarja e lindshmërisë sot për një grua apo çift, ndërkohë dhjetë vjet më parë mesatarja e lindshmërisë rezultonte të ishte 3,4 fëmijë për një grua.

20

Gra të dhunuara janë strehuar në një nga qendrat e ngritura për të mbrojtur viktimat e dhunës, ndërkohë që një pjesë e tyre kanë marrë me vete edhe fëmijët, plot 16 fëmijë



Sonila Isaku

sonilaisaku@kohajone.com

Çiftët në karrierë, lindshmëria është përgjysmuar

Raporti, femrat paguhen 17% më pak se meshkujt



Gratë e dhunuara, 20 raste strehohen në qendër

Lidhur me ngritjen e strukturave për të mbështetur viktimat e dhunës në familje dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me çështjet e dhunës në familje, Ministri i Punës, Spiro Ksera, ka përmendur iniciativat e ndërmarra si gjatë vitit 2011 si hapja e Strehëzës së parë Kombëtare për viktimat e dhunës në familje. "Deri tani në këtë Qendër janë pritur dhe trajtuar mbi 20 raste, gra viktime të dhunës në familje me 16 fëmijët e tyre. Në këtë qendër përfituese u ofrohen të gjitha shërbimet, ku përfshihen edhe programe rehabilituese dhe riintegruese", - ka pohuar Ksera. Ngritja dhe funksionimi i kësaj strehëze u mbështet nga UNDP në kuadrin e Programit "Një OKB".

GJETJA

Ndër gjetjet kryesore të raportit është fakti që zonjat kryefamiljare, edhe pse më të ardhura më të vogla se mashkulli kryefamiljar, i menaxhojnë më mirë këto burime dhe shpesh herë arrijnë të nxjerrin familjen e tyre nga varfëria. Gjatë takimit, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Spiro Ksera, theksoi se çështja e gruas është shumë e rëndësishme për vendin tonë.



Gjatë prezantimit të raportit mbi barazinë gjinore

Në Shqipëri femrat janë më të arsimuara, numri i atyre që përfundojnë universitetin është shumë më i lartë se meshkujt, por ato paguhen më pak, dhe konkretisht 17.63 për qind më pak se meshkujt. Të dhënat janë bërë publike në raportin e fundit Kombëtar mbi Barazinë Gjinore në vendin tonë. Sipas këtij raporti, edhe pse ka më shumë femra të arsimuara, sërish ato mbeten më të papuna se burrat dhe më pak të paguara se ata. "Pjesëmarrja e meshkujve në tregun e punës ka mbetur pothuajse e qëndrueshme, ndërsa pjesëmarrja e grave ka rënë më shumë duke rritur hendekun përkatës gjinor. Nga 18.2 për qind në vitin 2007 në 21.5 për qind. Hendeku gjinor paraqitet edhe tek pagesat. Paga mesatare e grave është 17.63 për qind më e vogël se e burrave me të njëjtin nivel arsimor", - ka pohuar gjatë prezantimit të raportit, zv.ministria e Punës, Filloreta Kodra. Sipas saj, për burrat shkalla e papunësisë ra në nivelin e 12.2. Sipas të dhënave, thuhet se gratë janë kryesisht të punësuar në shëndetësi dhe punë sociale ku për-

faqësojnë 76.2 për qind e të punësuarave. Në arsim dhe bujqësi ato përbëjnë më shumë se gjysmën e punonjësve. Ndërkohë që raporti evidenton faktin se në administratën publike gratë gjenden në nivele të mesme dhe shpesh të ulëta ndërsa burrat kryesisht zënë rangjet më të larta. Por ajo që vihet re në këtë raport gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit është ulur edhe lindshmëria. Nëse në vitin

2000, mesatarja e lindshmërisë ishte 3,4 fëmijë për një grua, tani ajo është ulur ndjeshëm në 1,5 fëmijë për një grua. Ndërkohë, ajo që është më shqetësuese në zonat rurale është braktisja e shkollës nga vajzat. Raporti tregon se në zonat rurale rreth një e treta e femrave nuk ndjekin arsimin parashkollor dhe atë nëntëvjeçar. Megjithatë më të privilegjuar në arsimin parauniversitar, mesh-

kujt gjithsesi janë më të paktë nëpër universitete. Vetëm një e treta e të regjistruarave dhe e të diplomuarave në universitete, janë meshkuj. "Arsimi, regjistrimi tregon një tendencë graduale në ulje si për vajzat ashtu dhe për djemtë. Në regjistrimin bruto të vajzave në nivelin e arsimit fillor 2-4 për qind më pak se vjet. Në fund të shkollës së mesme për qindja e vajzave që marrin diplomë është

dukshme më e lartë se djemtë. Të diplomuarat femra nga universitetet publike përbën rreth 2/3 e gjithë studentëve me kohë të plotë në Shqipëri", - tha Filloreta Kodra, zv.ministria e PCSSHB. Raporti i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale do t'u dërgohet të gjitha institucioneve, me qëllim që të rishohin dhe të ndryshojnë politikën për të fuqizuar figurën e gruas në vend.

PROVIMI



Matura Shtetërore, më 24 maj "ngujohen" hartuesit e tezës

Java e ardhshme do të shënojë sezonin e përgatitjeve finale për provimet e maturës shtetërore 2012, që fillojnë më 1 qershor me provimin e parë të detyruar në Letërsi e Gjuhë shqipe. Duke iu referuar të dhënave të zbardhura nga plotësimi i formularëve A-1, bëhet me dije se në testimin e parë të maturës do të marrin pjesë rreth 43600 maturantë nga të gjitha shkollat e mesme të

vendit. Burime pranë Ministrisë së Arsimit bëjnë me dije se është hartuar tashmë fondi i pyetjeve, nga ku do të përzgjidhen në fshehtësi të plotë 25 pyetjet finale që do të jenë në tezën e provimit. Më datën 24 maj, në ambientet e AVA-s do të ngujohet grupi i ekspertëve të lëndës së letërsisë, të cilët në izolim të plotë për një javë rresht do të përgatitin testet e provimit.

SINOPTIKA



Moti i paqëndrueshëm, dielli rikthehet në fundjavë

Reshjet e shiut që prej dy ditësh kanë rambuluar pothuajse gjithë vendin do të jenë prezent deri ditën e premtë. Specialistët sqarojnë se do të ketë një episod të shkurtër pushimi të tyre ditën e mërkurë, por të enjten reshjet do të rikthehen. Po kështu dhe temperaturat do të vazhdojnë të jenë më të ulëta se ato të javës së shkuar. Parashikohet që situata e paqëndrueshme

motit të parashikohet deri në mesin e javës, pra deri në ditën e enjte. Përmirësimi i motit do të jetë vetëm në pjesën e dytë të ditës së premtë, në të cilën vranësirat dhe shirat do të vendosen në zonat malore, në të cilat do të ketë shira të karakterit lokal, ndërsa fundjava parashikohet të jetë me mot të kthjellët dhe vranësira të lehta, po-hojnë meteorologët.





klan HD 24 ORE NE HD
 Cilësia më e lartë e transmetimit televiziv në botë,
 tani mban emrin KLAN HIGH DEFINITION!
 Në valë tokësore FALAS, pa pagesë sponjë për dekoder!

www.tvklan.al

16.05.2012 →



PRIME TIME

CSI NY

Serial premierë, ep. 139

21:05

Pika e veshtrimit

Mek është deshmitar rastesisht në një çështje. Disa ngjarje të çuditshme mund të jenë të lidhura me një hetim që po vazhdon. Kur pistat ftohen dhe duket sikur nuk ka shumë lidhje, serish Mek bëhet deshmitar i fakteve që mund ta lidhin atë me dicka të njohur.

Guida TV Sot

- 06:00 EZEL serial R, ep.76
- 06:59 ALDO MORNING SHOW emision LIVE
- 09:00 LAJME FLASH
- 10:10 SHAMIKUQJA tln R, ep.9
- 11:15 X FACTOR backstage 92 R
- 12:00 LAJME
- 12:15 OPINION emision R
- 14:10 PROMOZONE emision LIVE
- 15:30 LAJME & MOTI
- 16:10 BOTE TE NDARA telenovele premiere, ep.80/2
- 16:40 X FACTOR backstage 93
- 17:15 SHAMIKUQJA tln premiere, ep.10
- 18:20 TAKIMI I PASDITES emision LIVE
- 19:30 LAJME & MOTI
- 20:05 EZEL serial premiere, ep.77
- 21:05 CSI NY serial premiere, ep.139
- 22:00 LAJME
- 22:30 OPINION emision LIVE
- 00:05 EZEL serial R, ep.77
- 01:00 BEVERLY HILLS 90210 serial, ep.20
- 02:00 ANATOMIA E GREIT serial, ep.106
- 03:00 OPINION emision R

SHAMIKUQJA

telenovele premiere

ep. 10

17:15

Gjithcka është gati për martesën e Iljazit dhe Asijes. Por ditën e dasmës Helini i bën një surprizë të madhe Iljazit. Si do të pritet kjo surprizë nga Asija? Iljazit është në një situatë shumë të vështirë...



ALDO MORNING SHOW
 emision LIVE
06:59

Në 7 pa 1 minute nga e hëna në të premte ALDO MORNING SHOW ju fton të zgjoheni me një adrenaline të papare për ta nisur mbare ditën. Telefonata nga të gjithë shqiptarët, muzike vetëm për t'u zgjuar, tema interesante, biseda nga me të ndryshmet, informacione urbane, çdo mëngjes direkt nga: Tirana, Shkoder, Lezha, Durrësi, Elbasani, Korça, Vlora, Gjirokastra. ... dhe dielli lind ndryshe në Klan.

EZEL
 serial premiere, ep.77
20:05

Ramizi urdheron Aliun të vrasë Kenanin. Kush do ta ndihmojë atë? A do ta besojë Mumtazi Ezelin që ai është Omeri? Një reviste kërkon të punesoje Merfin dhe kush ka gisht në këtë oferte? Ramizit do t'i duhet të përballet me një tjetër lajm...





CORTEFIEL



Koleksioni Pranverë - Verë 2012

TEG
www.teg.com



VLORË/ "24 Orë" prangos të dyshuarin Brisild Ismaili

Plagos në grabitje në qendër të qytetit, kapet në arrati

VLORË - Plagosi në grabitje një burrë te monumenti i "Pavarësisë", kapet në arrati i dyshuari. Një 21-vjeçar është arrestuar gjatë orëve të vona të mbrëmjes së hënë nga policia e Vlorës, pasi akuzohet për vjedhje me dhunë. Burime zyrtare nga policia vendore bënë me dije se është finalizuar me sukses operacioni i koduar "24 Orë 2", ku si rezultat i të cilit është realizuar ndalimi i Brisild Ismaili, që akuzohet se ka plagosur me thikë 51-vjeçarin me inicialet G. D. Ngjarja ka ndodhur mbrapa monumentit të "Pavarësisë" në qendër të qytetit, ku pas një konflikti për motive të dobëta 21-vjeçari ka rrahur dhe plagosur me sende të forta 51-vjeçarin, të cilit i ka marrë edhe lekët dhe gjithë sendet personale që kishte me vete. Në cilësinë e provës materiale autorit të dyshuar i

ELBASAN

Mbante armë në banesë, nën akuzë 55-vjeçari. Policia e Elbasanit ndaloi dje Kasëm Dragotin, banues në komunën Kajan, pasi nga kontrolli i ushtruar në banesën e tij iu gjendën dhe sekuestruan si provë një armë zjarri pushkë, si dhe 30 fishekë pistolette, që i mbante pa leje, akuzë edhe për të cilën po hetohet.

është gjetur dhe sekuestruar një bluzë me disa njolla gjaku. Ndërkohë, materialet procedurale në ngarkim të 21-vjeçarit i janë dorëzuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale "vjedhje me dhunë". Pas sul-

mit i dëmtuari përfundoi në spital ku dhe mori mjekimin e duhur dhe kaloi rrezikun për jetën. Vetë i plagosuri denoncoi të riun duke e identifikuar, ndërkohë që policia po verifikon nëse ka marrë pjesë edhe në krime të tjera.



Vendi ku ka ndodhur grabitja

Jepen 41 vite burg për 6 të pandehurit. Irritohen familjarët, kërcënojnë me vetëgjyqësi

I falet burgu përjetë vrasësit të taksistit



Artur Qoraj

arturqoraj@kohajone.com

KORÇË - Gjykata e Korçës zbaton vendimin e dhënë nga Apeli dy muaj më parë dhe lehtëson dënimet për vrasësit në grabitje të taksistit Fredi Talelli, në 24 nëntor të vitit 2010. Vendimi i djeshëm ka sjellë rritim të familjarëve të të ndjerit në sallën e gjyqit, teksa babai i 38-vjeçarit, Fiqiri Talelli, u shpreh se "kjo është një padrejtësi, u vramë për të dytën herë dhe do mendojmë vetëgjyqësinë!". Gjykata dha në total për 6 të pandehurit vetëm 41 vite burgim, kur prokuroria kërkoi të paktën një burgim të përjetshëm dhe një tjetër me 25 vjet. Organi i akuzës nuk hoqi dorë edhe në procesin e dytë nga dënimet maksimale në presencë, por trupi gjykues zbatoi verdiktin e Apelit. Sipas këtij vendimi, në rastin e autorit kryesor, Elkero Revani, nuk ishte aplikuar gjykimi i shkurtuar siç kishte kërkuar i pandehuri dhe avokati i tij, që e shpëtonin nga burgu përjetë. Kurse për të pandehurin Arnest Xhaçka, Kodi Penal parashikonte një dënim nga 12 vjet burg dhe poshtë, duke marrë parasysh edhe gjykimin e shkurtuar. Në procesin e parë Revani u dënua me burgim të përjetshëm, kurse Xhaçka me 23 vite heqje lirie. Ditën e djeshme u dhanë 25 vite burgim për Revanin dhe 8 vite e 4 muaj heqje lirie për të miturin. Gjykata i shpalli fajtorë të gjashtë të pandehurit, por dy prej tyre fituan lirinë pasi ishin dënuar nga 6 muaj. Organi i akuzës ka kërkuar më herët burgim të përjetshëm për 21-vjeçarin Elkero Revani dhe 25 vite burg për 17-vjeçarin Arnest Xhaçka, si organizatorë dhe ekzekutorë të taksistit Talelli. Sipas akuzës, dy të rinjtë, jo vetëm që kanë planifikuar me detaje grabitjen e taksistit, por pasi e kanë qëlluar me armë zjarri, e kanë goditur me mizori disa herë në kokë me një çekan,



Babai i viktimës, Fiqiri Talelli gjatë një seance



Taksisti i vrarë, Fredi Talelli



Dy të pandehurit kryesorë të vrasjes

edhe pse viktimë kishte gjetur vdekjen më parë. Ndërsa për 4 bashkëpunëtorët e tjerë, mbi të cilët rëndon akuza e moskallëzimit të krimit dhe armëmbajtje pa leje, prokurori i çështjes ka kërkuar gjithsej 18 vite burg. Të gjithë të pandehurit, kanë shprehur pendim për veprimet e tyre dhe kanë kërkuar mëshirë, ndërsa mbrojtësit e tyre i kanë kërkuar gjykatës masa më të buta dënimi. Trupi gjykues në fund të procesit vendosi të dënojë me 25 vite burg Revanin, 8 vite e 4 muaj burg Xhaçkën dhe 9 vite burg gjithsej për 4 të pandehurit e tjerë. Mekaniku Domeniko Kumria

dhe Kastriot Papeleka që fshehën provat e krimit u dënuan me 5 dhe 3 vjet burg, teksa Jur-

POGRADEC

Vdekja e punëtorit, akuzë teknikut të punimeve në pallat

Vdekja e punëtorit mesditën e së hënës, pasi ra nga një pallat i ri në lagjen nr. 1 të Pogradecit, çon nën akuzë teknikun e firmës ndërtime. Strukturat e Hetimit dhe Parandalimit të Krimit, bënë me dije se filloi procedimi penal në gjendje të lirë në ngarkim të V. Dervishi, 60 vjeç, banues në lagjen nr. 4 të qytetit, me detyrë teknik zbatues punimesh në pallatin në ndërtim e sipër. Gjatë punës ka rënë nga kati i katërt dhe ka gjetur vdekjen K. Tomorri, 54 vjeç, i cili ishte caktuar nga drejtuesi teknik si roje i këtij objekti. Vepra penale e ngritur nga policia është "shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", kurse dosja i kaloi prokurorisë vendore për veprime të mëtejshme.

gen Zeqaj dhe Amarildo Selmani morën nga 6 muaj burgim si në procesin e parë. Të gjithë të pandehurit kanë përfituar uljen me një të tretën e dënim-it, për shkak të aplikimit të gjykimin të shkurtuar. Vendimi i gjykatës ka sjellë reagimin e familjarëve të taksis-

tit të vrarë, të cilët e kanë konsideruar atë të padrejtë, në raport me krimin mizor të kryer nga 6 të rinjtë. Pas vendimit ka reaguar babai i viktimës, Fiqiri Talelli, i cili është shprehur i indignuar për vendimin, duke paralajmëruar se do të bëjë vetëgjyqësi.

Një orë shi, kthen në liqen Vlorën

Reshjet që kanë rënë në Vlorë kanë rishfaqur problemet e kanalizimeve në qytet. Bulevardi kryesor, si edhe rrugët dytësore, janë përfshirë nga uji. Qarkullimi i këmbësorëve është vështirësuar pothuajse në të gjitha akset dytësore, ndërsa në bulevard automatjet kalojnë mbi "liqenet" e ujit të shkaktuar nga bllokimi i kanalizimeve, ndërsa parkimi në të dy anët e trotuarëve është i vështirë për shkak të nivelit të ujit të akumuluar në anët e karexhatës. Nga ana e bashkisë dhe Ndër-

marrjes së Shërbimeve Publike në qytet, ndërhyhet vetëm në zhblokimin e pusetave kur uji është ngritur disa centimetra mbi rrugën e asfaltuar. Bashkia e Vlorës nuk ka ndërhyrë për sistemin e kolektorëve të qytetit për largimin e ujërave të shiut, për t'i dhënë dhe zgjidhje një problemi shqetësues, sikundër janë përmblyet. Problematike gjendja në zonat e njohura si "Albano e Romina", në kryqëzimin pranë ishdyqaneve të reja, apo në lagjet "1 Maji" dhe "24 Maji".

O. H

PUKË

E rrihte burri, thërret policinë

Pas denoncimit të dhunës sistematike në familje nga bashkëshorti, Luçe M., nga fshati Mzi i Pukës, është marrë në mbrojtje nga policia e këtij rrethi pas denoncimit të depozituar. Kreu i policisë së komisarit, Ritvan Bushati, ka udhëtuar në fshatin e thellë, ku dhe ka vendosur forca të rendit në mbrojtje të gruas, nënë e dy fëmijëve. Gjatë marrjes në pyetje, 51-vjeçarja ka rrëfyer se si është keqtrajtuar nga bashkëshorti dhe se ndihej e kërcënuar për jetën së bashku me fëmijët e saj. Psikologët kanë kërkuar që ajo të strehohej në një qendër rehabilitimi.

ITALI

Droga, goditen 2 grupe shqiptarësh

Policia italiane ka shkatërruar dy banda shqiptare të trafikimit të kokainës ndërsa janë arrestuar 11 të dyshuar. Lajmi bëhet i ditur nga mediat e vendit fqinj, të cilat theksojnë se operacioni antidrogë është ndërmarrë në orët e para të mëngjesit të djeshëm në qytetin e Venecias. Sipas policisë dhe Guardia di Financës, dy grupet e trafikimit kishin lidhur një pakt që të mos sulmonin njëri-tjetrin, ndërsa bashkëpunonim për të shpërndarë drogën në qendër historike të qytetit. Sipas hetimeve të kryera, droga hynte në shtetin italian përmes vendeve të Ballkanit, por edhe nga vendete ulëta.

FIER

Përplasen furgonët, tre të plagosur

Një aksident rrugor me pasojë plagosjen e 3 personave ka ndodhur paraditen e djeshme në Fier. Dy furgonë janë përplasur dhe për pasojë janë plagosur shtetasit Dyshan Zeqo dhe Gëzim Mehmeti, përkatësisht nga 57 vjeç dhe 22-vjeçarja Aida Bestrova. Menjëherë të plagosurit janë dërguar me urgjencë në spitalin e Fierit dhe sipas mjekëve gjendja e tyre shëndetësore është jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë që policia po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve të aksidentit të ndodhur. Shkak paraprakisht dyshohet se ka qenë pakujdesia dhe shpejtësia e madhe, por edhe lagështira në rrugë.

TIRANË **Bastisi shkollën 9-vjeçare, kapet pas 6 muajsh**

Një 21-vjeçar është arrestuar nga policia, pasi akuzohet për vjedhjen e një shkolle 9-vjeçare. Jonuz Leka, 21 vjeç, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë u arrestua dy ditë më parë nga efektivet e komisariatit të policisë nr. 1, për akuzën e "vjedhjes". Burime nga policia thanë se i riu dyshohet se me datë 20 tetor të vitit të kaluar ka vjedhur me thyerje shkollën 9-vjeçare "Nexhmi Tafaj" në fshatin Daias, komuna Petrelë, Tiranë. Dokumentimi i vjedhjes u krye më 8 maj të këtij viti kur u shpall në kërkim edhe 21-vjeçari. Dy ditë më parë, policia siguroi informacione për vendndodhjen e Lekës duke kryer më pas dhe arrestimin e tij për veprën penale të "vjedhjes".

ARRESTIMI **Mbante armë në banesë, policia i zbulon**

Policia e Tiranës arrestoi dy ditë më parë një 28-vjeçar, pasi mbante armë në banesë. Fatmir Musaj, 28 vjeç, u kap nga shërbimet e komisariatit të policisë nr. 2, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij rrugën "Irfan Tomoni", Tiranë, iu gjet një armë zjarri automatike "Kallashnikov", mod 56, kalibër 7.65 mm, si dhe një sasi

fishekësh, të cilën e mbante pa leje. Burime nga policia thanë se arma u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, ndërsa i riu u shoqërua në ambientet e komisariatit ku dhe u mor në pyetje. Pas dëshmisë së tij dhënë para oficerëve të policisë, ndaj 28-vjeçarit u mor masa e arrestit për veprën penale të "armëmbajtjes pa leje".

Ngjarja pas sherrit në familje, dënimi nga Gjykata e Elbasanit

Vranë nënën dhe motrën, 39 vjet burg 2 vëllezërve

Dy vëllezër u dënuan me 39 vite burg për vrasjen e nënës dhe motrës së tyre. Gjykata e Elbasanit shpalli fajtor ditën e djeshme dhe dënoi me 39 vite burg dy vëllezër, të cilët akuzohen se kanë vrrarë nënën dhe motrën gjatë një konflikti në familje. Leonard Leka u dënua me 25 vite burg, ndërsa vëllai i tij, Dritan Leka, me 14 vite burg. Ata u akuzuan se mbrëmjen e 18 marsit të vitit 2011 qëlluan me pushkë nënën e tyre, Donika Leka, 63 vjeçe, dhe motrën Manjola, 32



Banesa ku ndodhi ngjarja

vjeçe. Prokuroria kërkoi burgim përjetë për dy të akuzuarit, por trupi gjykoes e hodhi poshtë kërkesën e organit të akuzës, duke dënuar me 39 vite burgim vëllezërit. Leonard Leka u akuzua se qëlloi me pushkë mbi nënën dhe motrën e tij, ndërsa Dritan Leka si bashkëpunëtor dhe moskallëzim krimi. Nënë e bijë u ekzekutuan mbrëmjen e 18 marsit të vitit të shkuar në banesën e tyre në Elbasan gjatë një konflikti familjar. Njëri prej djemve të familjes, Le-



Gjykata e Elbasanit

onard Leka dyshohet se konsumonte sistematikisht lëndën narkotike dhe pije alkoolike, për të cilën është qortuar nga motra e tij. Mes tyre ka nisur një sherr, i cili ka përfunduar në përdorimin e armës. Leka ka marrë një pushkë dhe ka qëlluar tre herë mbi motrën 32-vjeçare duke e lënë të vdekur në vend. Nëna është hedhur menjëherë mbi vajzën e saj për ta mbrojtur, por edhe ajo është qëlluar tre herë nga djali, i cili e ka lënë të vdekur në vend. Ndërkohë që në krim ka marrë pjesë edhe djali tjetër i familjes, Dritan Leka i cili më pas është larguar me shpejtësi duke fshehur ngjarjen. Rreth 12 orë pas vrasjes së dyfishtë, fqinjët e familjes Leka lajmëruan policinë, pasi reflektuan mbi të shtënat që kishin dëgjuar gjatë natës, për të cilat fillimisht dyshuan se ishin fishekzjarrë. Polici mbërriti në banesën e familjes Leka ku gjeti dhe trupat e pajetë të dy femrave. Dri-

tan Leka u kap në Pogradec gjatë arratisjes, ndërsa Leonard Leka u vetëdorëzua në polici sapo mësoi se ishte shpallur në kërkim. "E vrava motrën për nder, pasi mësova se ajo kishte një lidhje intime, ndërsa nëna ndërhyri mes nesh", - deklaroi ara oficerëve të policisë së Elbasanit, Leka vetëm pak orë pas arrestimit. Donika dhe Manjola Leka, jetonin prej disa vitesh me dy djemtë e familjes, Leonardin dhe Dritanin. Sipas policisë, 65-vjeçarja ishte divorcuar me të shoqin, i cili jetonte në një banesë pak metra më larg, por të tre fëmijët kishin zgjedhur të jetonin me nënën e tyre. Familja Leka banonte në një shtëpi private në lagjen "11 nëntori" në Elbasan. Autori i krimit kishte debate çdo natë me familjarët e tij, pasi ai shpesh konsumonte alkool dhe substanca narkotike, nën efektin e të cilave qëlloi me pushkë mbi nënën dhe motrën. **K.K**

Policia: Dyshohet se ka realizuar disa vjedhje në Tiranë

Policia e kishte shpallur në kërkim, 19-vjeçari kryente vjedhje

Një 19-vjeçar nuk ka nguruar të kryejë vjedhje, megjithëse kërkohet nga policia. David Dule është ndaluar, pasi kishte kryer vjedhjen e një dyqani, ndërsa policia bëri të ditur se ai ishte shpallur në kërkim për një tjetër vjedhje. Burime nga policia thanë se 19-vjeçari ishte shpallur në kërkim për veprën penale të "vjedhjes e kryer në bashkëpunim".



Ai dyshohet se në bashkëpunim me një person tjetër, më 21 shkurt të këtij viti ka vjedhur banesën e shtetasit F. E., në lagjen e Re Vorë, ngjarje e ndodhur me datë 21.02.2012. Ndërkohë që policia kishte nisur kërkimet për lokalizimin e vendndodhjes së 19-vjeçarit, ai planifikoi një tjetër vjedhje. Shtetasi A. Z., banues në Vorë, se në Rrugën Demokracia Vorë, denoncoi në

policia pak ditë më parë gjatë orëve të natës, i kanë vjedhur dyqanin ushqimor, ku kanë marrë 15 000 lekë dhe një sasi malli me vlerë 5 000 lekë. Nga kryerja e veprimeve procedurale e hetimore rezultoi se autori i dyshuar i vjedhjes së këtij dyqani rezultoi të jetë David Dule. Policia tha se ai u kap dy ditë më parë nga efektivet e komisariatit të policisë nr. 4, pranë

banesës së tij në Tiranë. Burime nga policia thanë se aktualisht janë dokumentuar dy vjedhje të realizuara prej 19-vjeçarit, ndërsa po vazhdojnë hetimet për të dokumentuar të tjera vepra penale të kryera prej tij. Në ngarkim të David Dules, policia ka ngritur akuzat e "vjedhjes" dhe materialet i kaluan Prokurorisë për hetime të mëtejshme.

AKSIDENTI NË TIRANË

Makina përplas për vdekje 62-vjeçarit, arrestohet drejtuesi

Tenton të kalojë në anën tjetër të rrugës, por përplasët nga një automjet. A. Musta, 62 vjeç, ndërroi jetë në orët e para të ditës së djeshme në Spitalin Usharak në Tiranë, pasi u përplas nga një makinë. Ngjarja ndodhi mbrëmjen e së hënës në Bulevardin "Bajram Curri" në Tiranë kur automjeti fuoristradë "Toyota" me targa TR 6099 U që drejtohej nga Fatmir Mali, 45 vjeç, përplasi këmbësorin A. Musta, 62 vjeç. Drejtuesi i mjetit transportoi për në spital të aksidentuarin, i cili u shtrua menjëherë në reanimacion në gjendje të rëndë shëndetësore. Mësohet se rreth 7 orë pas aksidentit, 62-vjeçari ndërroi jetë në spital për shkak të plagëve të rënda që kishte marrë në kokë. Policia shoqëroi drejtuesin e mjetit Fatmir Mali, i cili, pasi u mor në pyetje, u arrestua për veprën penale të "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor". Pas hetimeve të kryera në vendngjarje, policia deklaroi se aksidenti ndodhi si rrjedhojë e shpejtësisë së madhe, me të cilën po udhëtonte automjeti. Sipas policisë, 62-vjeçari po tentonte të kalonte në anën tjetër të rrugës ku u përplas nga makina.



Studentë të Fakultetit Histori-Filologji në Tiranë

Tafaj firmos udhëzimin e ri, publikohen ndryshimet

Njohja e diplomave, MASH ndryshon procedurat



Luljeta Ndoka

luljetandoka@kohajone.com

Ndryshojnë procedurat për njohjen e diplomave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, ka firmosur një udhëzim të ri, në funksion të atij të vitit 2009, duke i bërë

edhe disa përforsime, që konsistojnë kryesisht në masat e sigurisë. Kështu, sipas udhëzimit, dosja e aplikimit do të përmbajë Formatin e aplikimit të plotësuar diplomën ose certifikatën, apo vërtetimin e diplomimit, listën e notave ose suplementin e diplomës, një dokument zyrtar identiteti dhe mandatpagesën. Ndërsa në udhëzimin e vjetër përcaktohej se këto dokumente duhet të jenë me përkthim të vërtetuar, tashmë në kuadër të masave të sigurisë, kërkohet që për shtetasit e huaj, këto dokumente duhet të jenë të përk-

thyer në gjuhën shqipe nga përkthyer të licencuar, si dhe të noterizuara. Nga ana tjetër, diploma dhe lista e notave duhet të jenë të pajisura me vulën apostile. Në rastet kur kjo vulë mungon, sipas sektorit të njohjes së diplomave, kryhen verifikimi me postë, faks ose e-mail me institucionin e arsimit të lartë ku është kryer kursi i studimeve. Nga ana tjetër, një ndryshim jo të vogël përmban edhe pika 3,4 e udhëzimit, sipas së cilës, komisioni kur ka dyshime mbi vërtetësinë e diplomës, pezullon

procedurën e njohjes dhe përcaktton afatet dhe masat për mbylljen e saj. Sipas udhëzimit më të fundit të Ministrisë së Arsimit, pika 4,4 ka vendosur që të shtojë të dhënat në dokumentin e njohjes. Kësisoj, në dëshminë e njohjes më parë shënoheshin vetëm vitet e studimit, profili i diplomës dhe ndonjë drejtim sekondar. Por, me udhëzimin e ri, formati i vërtetimit të njohjes dhe njehsimit ka edhe një shtojcë, që përmban një sërë elementesh. Bëhet fjalë për emrin, atësinë dhe mbiemrin e kandi-

datit, institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën, shteti përkatës, kohëzgjatja e programeve të studimit, titulli i diplomës, emërtimi i programit të studimeve të kryera, shoqëruar me kreditet ECTS, në ato raste kur është e mundur që këto të përcaktohen në bazë të të dhënave të suplementit të diplomës, ose listës së notave. Ndërkaq, në suplementin e vërtetimit të njohjes shënohet edhe njehsimi i diplomës përkatëse të lëshuar në bazë të ligjit të arsimit të lartë, i ndryshuar.

Certifikatat që do të njihen nga MASH

Udhëzimi, shtohet spektri i diplomave që njihen

Udhëzimi i fundit ka shfuqizuar gjerësisht të pikës 1 të udhëzimit të më parshëm, i cili nuk lejonte njohjen e disa llojeve të diplomave dhe vërtetimeve. Kjo do të thotë se ato do të mund të njihen tashmë nga Ministria e Arsimit. Kështu, duke filluar nga hyrja në fuqi e udhëzimit, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës do të mund të njohë një kategori të ndryshme kurseesh dhe vërtetimesh. Bëhet fjalë për diploma dhe kualifikime të fituara nga institucione të akredituara në Republikën e Shqipërisë, kurse studimi të paplotësuar; këto shqyrtohen nga Institucioni i Arsimit të Lartë, ku aplikanti kërkon të vijojë/përfundojë studimet, në përputhje me statutin/rregulloren e tij, certifikata për kurse të vetme si gjuhë e huaj, kompjuter etj., diploma ose certifikata lëshuar nga institucione të huaja që nuk kanë legjitimitetin e duhur, dokumentet që nuk janë origjinale apo të njëvlefshme me to, diploma ose certifikata të fituara në shkolla të larta ushtarake, përjashtuar diplomatat për drejtime civile të studimeve, diploma dhe certifikata të fituara në shkolla të larta fetare, përjashtuar diplomatat për drejtime civile të studimeve.

PROCEDURAT SI ISHIN:

- 1-Dokumentet ishin me përkthim të vërtetuar
- 2-Kur komisioni kur ka dyshime mbi vërtetësinë e diplomës, njofton Ministrin e Arsimit. Komisioni vendos se si do të veprojë
- 3-Vërtetimi i njohjes përmbante vetëm titullin e studimit dhe profilin e diplomës
- 4-MASH nuk njohte diploma dhe kualifikime të fituara nga institucione të akredituara në Republikën e Shqipërisë, kurse studimi të paplotësuar; këto shqyrtohen nga Institucioni i Arsimit të Lartë, ku aplikanti kërkon të vijojë/

përfundojë studimet, në përputhje me statutin/rregulloren e tij, certifikata për kurse të vetme si gjuhë e huaj, kompjuter etj., diploma ose certifikata lëshuar nga institucione të huaja që nuk kanë legjitimitetin e duhur, dokumentet që nuk janë origjinale apo të njëvlefshme me to, diploma ose certifikata të fituara në shkolla të larta ushtarake, përjashtuar diplomatat për drejtime civile të studimeve, diploma dhe certifikata të fituara në shkolla të larta fetare, përjashtuar diplomatat për drejtime civile të studimeve.

PROCEDURAT SI BËHEN:

- 1-Dokumentet duhet të jenë të përkthyer në shqip nga përkthyes të licencuar e të noterizuara
- 2-Diploma dhe lista e notave duhet të jenë të pajisura me vulën apostile. Në rastet kur ajo mungon, sipas sektorit të njohjes së diplomave, kryhen verifikimi me postë, faks ose e-mail me institucionin e arsimit të lartë ku është kryer kursi
- 3-Kur komisioni ka dyshime mbi vërtetësinë e diplomës, pezullon procedurën e njohjes dhe përcaktton afatet, masat për mbylljen e procedurës
- Formati i vërtetimit të njohjes dhe njehsimit ka një

shtojcë, që përmban disa elemente. Bëhet fjalë për emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën, shteti përkatës, kohëzgjatja e programeve të studimit, titulli i diplomës, emërtimi i programit të studimeve të kryera, shoqëruar me kreditet ECTS, në ato raste kur është e mundur që këto të përcaktohen në bazë të të dhënave të suplementit të diplomës, ose listës së notave

BASHKËPUNIMI



MASH: Universitetet kineze që ofrojnë studime për mjekësi në anglisht

Ministria e Arsimit e Republikës Popullore të Kinës shpall listën e universiteteve dhe të programeve përkatëse për kandidatët universitarë dhe pasuniversitarë që duan të aplikojnë kryesisht në fushën e mjekësisë klinike për vitin akademik 2012-2013. Kursi ofrohet në gjuhën angleze. Ndërsa universitetet e tjera jashtë kësaj liste nuk ofrojnë studime universitare në gjuhën angleze, por

vetëm në gjuhën kineze për studentët e mjekësisë për të gjitha nivelet dhe në raste të veçanta për studentë pasuniversitarë, të cilët mund t'i vijnë këto studime në gjuhën angleze. Për më tepër, informacion në lidhje me këtë ofertë referojnë listës së Institucioneve të Arsimit të Lartë bashkëlidhur këtij njoftimi, e cila gjendet edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Republikës Popullore të Kinës.

EKONOMIKU



Doktorantët në borxhe, nuk do të futen në provime nëse nuk paguajnë

Studentët e ciklit të tretë të doktoraturës, edhe pse e kanë nisur vitin akademik në vitin 2010-2011, nuk kanë shlyer ende detyrimet financiare ndaj Fakultetit të Ekonomisë. Duke u nisur nga kjo, ky fakultet ka vendosur t'u japë një shans të fundit atyre. Kështu, dekanati i Ekonomikut ka lajmëruar se studentët do të çregjistrohen automatikisht nëse deri më datë 20 maj nuk kanë

shlyer pagesën e taksës së regjistrimit në masën 10.000 lekë si dhe atë të tarifës së shkollimit (2 këstet e para në vlerë totale 140.000 lekë. Sipas burimeve nga Fakulteti i Ekonomisë, kuponi për të bërë pagesën në bankë tërhiqet pranë zyrës së informacionit. Një kopje e mandatit të taksës së regjistrimit dhe tarifës së shkollimit dorëzohet pranë zyrës përkatëse ku gjendet dosja e aplikantit.

AKP: Kjo metodë aplikohet për herë të parë

Maturantët me dy teste biologjie, si do vlerësohen

Për herë të parë këtë vit në provimet e Maturës, maturantët do të kenë përpara vetes dy teza për lëndën e Biologjisë, ndërsa do të zgjedhin t'i përgjigjen njëres apo të dyjave. Specialistët e provimeve shpjegojnë se risia për Maturën e vitit 2012 në lëndën e Biologjisë është se do të hartohen dy teste, kështu nxënësit do të mund të zgjedhin njërin ose të dy së bashku. Specialistët kanë përcaktuar se çfarë temash do të përmbajë provimi për të dyja lëndët, Biologjia bërthamë dhe Biologjia e thelluar dhe se cila do të jetë pesha e tyre. Specialistët e provimeve shpjegojnë se në lëndën e Biologjisë pyetjet e nivelit të parë (njohje të kuptuar) janë në përgjithësi pyetje që kërkojnë përshkrime të thjeshta të ndërtimit të trupit të gjallesave, emërtime të gjallesave sipas klasifikimit të tyre etj. "Këto pyetje në testet e Biologjisë zënë një përqindje të lartë, kryesisht tek pyetjet me zgjedhje (me alternativa), si dhe mund të përfaqësojnë kërkesën e parë në ushtrimet me zh-



Maturantë

villim. Pyetjet e nivelit të dytë (zbatim në situata të reja), dhe pyetjet e nivelit të tretë (analizë, sintezë, dhe vlerësim), kryesisht kanë shtrirje kanë shtrirje më të gjerë në pyetjet me zhvillim", sqarojnë specialistët. Ata bëjnë të ditur se testet e Biologjisë, që do të kenë në total 40 pikë do të kenë 10 kërkesa me alternativa që vlerësohen të gjitha me 10 pikë, si dhe 10 ushtrime me zhvillim që vlerësohen të gjitha me 30 pikë.



Mjekët këshillojnë që të bëhet kujdes ndaj fëmijëve dhe të moshuarve

Ndryshimi i temperaturave, rriten rastet me viroza të stinës

Ulja e menjëhershme e temperaturave për vetëm dy ditë me pothuajse 10 gradë Celsius ka bërë që një numër i madh pacientësh t'i drejtohen mjekut për shkak të virozave duke u ndërthurur me alergjitë e stinës. Sipas mjekëve, kjo situatë është vetëm në raste të tilla kur luhatja e temperaturave është shumë e madhe, ndërkohë që janë mbi 30 pacientë në ditë, të cilët u drejtohen mjekëve për shkak të ndërthurjes së këtyre dy problemeve. Kryesisht, këta pacientë kanë lotim të syve, rrjedhje të hundëve dhe bllokim të tyre, kruarje të grykës apo të veshëve, simptoma këto të virozëve, por edhe të alergjive. "Një pjesë e mirë e pacientëve, të cilët janë të mësuar me alergjinë, drejtohen

për tek ne për të marrë mjekim, por ka nga ata, të cilët përveç alergjive kanë shfaqur edhe probleme të virozave. Këto të fundit kanë qenë të menjëhershme për shkak të ndryshimit të kushteve atmosferike", - ka pohuar mjeku Alergolog, Mehmet Hoxha. Alergologu thotë se pas vendosjes së diagnozës nga ana e mjekut, duhet të jetë ky i fundit, që duhet të vendosë dhe të aplikojë vaksinën. "Vaksinën e cakton mjeku alergolog, mund ta fillojë në çdo lloj periudhe. Ajo bën të mundur uljen në minimum të simptomave të alergjisë dhe parandalimin e komplikacioneve apo të rëndimit të alergjive dhe në këto raste janë rastet që kapen fillimisht, vendoset diagnoza dhe i nënshtrohen mjekimit të rekomanduar nga mjeku përkatës

alergolog dhe priten që këto raste të mos përsëriten shenjat, të jenë të reduktuara në minimum dhe të parandalohet rëndimi, apo komplikimi", - thotë Hoxha. Ai këshillon që pacientët në këtë periudhë duhet të jenë shumë të kujdesshëm për shkak të përsëritjes së alergjisë disa herë, si dhe shfaqjes së virozave. Gjatë kohës kur fryn erë, në ditët me mot të paqëndrueshëm këshillohen pacientët të mos ecin nëpër rrugë, pasi gjethet apo lulet shpërndahen më shumë në ajër. Ndërkohë, nga pavijoni i urgjencës së Pediatriisë në QSUT, raportohet për shtim të rasteve të fëmijëve, të cilët kanë probleme të virozave. Sipas mjekëve, gjatë 24 orëve paraqiten të paktën 150 deri në 170 pacientë të vegjël.

Mjeku specialist pohon se 1 në 10 meshkuj është impotent

Impotencia, Dani: Kequshqyerja, një nga shkaqet



Sonila Isaku

sonilaisaku@kohajone.com

Zbulimet e shkencës, vite më parë, duket se po tashmë po vërtetohen me raste konkrete edhe në vendin tonë. Konsumimi i alkoolit, duhanit apo edhe llojeve të ndryshme të drogave po sjell pasoja edhe në aktivitetin aktual të rinjve. Mjekët andrologë, por edhe ata psikiatër ndajnë shqetësimin, se kohet e fundit është rritur ndjeshëm numri i adoleshentëve dhe të rinjve, që u drejtohen atyre, pasi nuk arrijnë të kryejnë dot marrëdhënie seksuale. Impotencia seksuale nuk po prek më vetëm të moshuarit, por edhe moshat e reja. Sipas të dhënave të fundit, 13% e çifteve pa fëmijë kanë si shkak sterilitetin e partnerit. Ndërsa në studimet e bëra në Europë ku përfshijnë edhe Shqipërinë nga 10 meshkuj, 1 është impotent. Shkaqet emocionale mendohej të ishin të parat, ndërsa mjekët sot argumentojnë që impotencia vjen si pasojë e mbipeshës, kequshqyerjes, kolesterolit, stresit dhe abuzimit që bëjnë meshkujt me alkoolin duhanin e drogat. Përveç kësaj, andrologu Evin Dani thotë se në këtë impotencë deri në sterilitet ndikon edhe konsumi



mi i mishit të bagëtive, kur këtyre u bëhen injeksione për shtim të peshës. "Gjatë këtyre 20 vjetëve kemi një shtim të numrit të rasteve me impotencë që shkojnë deri në 13 për qind të çifteve, të cilët kanë probleme të infertilitetit. Faktorët janë të ndryshëm, por midistë tjerash mund të referohemi tek të dhënat e fundit të shkencës që kanë të bëjnë me shtimin e estrogenëve, shtimin e një hormoni ku njerëzit mund t'i marrin nga mënyra e të ngrënies", - ka pohuar Dani. Sipas tij, bagëtitë për t'i shtuar në peshë u injektohet ky lloj hormoni që sjell rritje e es-

trogjeneve. "Nëpërmjet këtij mishit, rritja e estrogenëve sjell uljen e numrit të spermatozoideve, dhe rrjedhimisht aftësinë për të riprodhuar. E vetmja mënyrë e parandalimit të impotencës apo sterilitetit është vizita që duhet të bëjnë meshkujt që në moshën e pubertetit. "Në këto raste të sterilitetit duhet të vizitohet mashkulli tek andrologu dhe femra tek gjinekologu. Kjo pasi shumë çifte për vite të tëra mbeten pa fëmijë, ndërsa nuk vijnë tek ne për t'u përballur me problemin", - ka pohuar Andrologu Evi Dani. Ky i fundit i bën apel meshkujve t'i drejtohen mjekut an-

PROBLEMET PSIKIKE

Mjekët raportojnë për ulje të moshës

Sipas të dhënave të raportuara nga strukturat shëndetësore mbi Srastet e evidentuara, konfirmohet se, nëse 20 vjet më parë komplikacionet e impotencës seksuale shfaqeshin te moshat e rritura mbi 50 vjeç, sot fatkeqësisht ky zbritur në kufij të konsiderueshëm, duke u klasifikuar si një shqetësim më vete. Kjo pasi të dhënat tregojnë që në listën e të prekurve nga kjo sëmundje po shfaqen edhe moshat e reja 18 apo 20-vjeçare. Sipas mjekëve, shumë adoleshentë kanë edhe probleme psikike, një pamundësi për të kryer deri në fund një marrëdhënie seksuale apo një ankth i shtuar qoftë edhe gjatë fillimit të një marrëdhënie me seksin e kundërt", - thonë mjekët. Çrregullimet psikike që ata shfaqin janë nga më të lehtat deri në më ekstremet, si për shembull nga ankthi, deri dhe depresionet e formave më të rënda.

MJEKU

Meshkujt nuk e njohin andrologun

Mjeku androlog Evi Dani pohon se është më se e vërtetë që për shumë meshkuj mjeku androlog është një fjalë e padëgjuar. Madje, edhe kur disa prej meshkujve mësojnë se ekziston një mjek që merret me problemet gjenitale të tyre, e keqinterpretojnë këtë profesion, duke e ngatërruar me atë të gjinekologut. "Shumë meshkuj, madje edhe kur kanë një nivel arsimor të mirë, nuk e njohin këtë specialitet. Kur disa prej tyre vijnë në ambulancën tonë, më pyesin nëse jam unë gjinekologu i meshkujve", - thotë mjeku androlog Evi Dani. Duket se vetëm halli i çon meshkujt në derën e mjekut androlog. Kultura e të vizituarit, qoftë edhe për të ditur se sa të shëndetshëm janë organet gjenitale të tyre, nuk ekziston.

1

Në 10 meshkuj ka probleme të impotencës seksuale. Sipas mjekëve, shkak për këto probleme janë ushqimet, por edhe faktorë të jashtëm si droga, alkooli dhe duhani.

drolog që në shenjat e para, pasi ekzistojnë medikamente që përmirësojnë gjendjen shëndetësore, duke ndikuar kështu edhe zgjidhjen e një sërë konfliktesh në çift, që vijnë si

13

Për qind e çifteve të reja kanë probleme të sterilitetit dhe nuk mund të lindin fëmijë. Mjekët këshillojnë vizita tek andrologu për meshkujt dhe tek gjinekologu për femrat.

pasojë e kësaj patologjie. Nga ana tjetër, mjekët konsiderojnë si më shqetësues faktin e uljes drastike të moshës së meshkujve që preken nga kjo sëmundje.



Kristaq Mitro: Arkivi i Filmit, në mëshirë të fatit

Arkivi i Filmit sot mbush 65 vjet, por ai kërkon ndihmë ose mëshirë nga të tjerët që janë privatë në këtë rast. Më vjen keq që arkivi është një institucion që ka shumë pak mbështetje dhe them me bindje se nuk ka arkiv në botë që të jetë si ne. I pe materialet e filmit që u shfaqën në dokumentarin, i kishin marrë nga Saimir Kumbaro, ndërkohë që ne e kemi biseduar gjithmonë që duhet të jetë një operator që të xhirojë këtu. Nuk ka arkiv në botë pa operator, është turp që nuk ka sot operator në arkiv. Më vjen keq që kjo nuk varet nga vetë AQSHP, sepse drejtuesit e saj e dinë dhe me siguri e kanë kërkuar, por duhet të jenë struktura të tjera ato që duhet ta shikojnë këtë.



Mevlan Shanaj: Arkivi, një shkollë që kërkon mbështetje

Arkivi Qendror i Filmit është institucioni më i lartë i kinematografisë, por sot ai kërkon mbështetjen e të gjithëve. Nëse sot nuk ka një grup xhirimi, atëherë ASHQF duhet të porosisë, por pyetja që shtrohet është nëse ka para për të mbajtur këtë grup? Eventet kombëtare, pavarësisht se sot janë dhjetëra kanale televizive, ata nuk përbëjnë Arkivin Qendror të Filmit, pasi janë arkiva të televizioneve private, janë në këmbë falë biznesit privat dhe këtu flasim për kujtesën kombëtare dhe duhet menaxhuar me efikasitet. Dokumenti i një kombi duhet të ruhet me shumë kujdes dhe këtë mund ta bëjë vetëm AQSHP, të tjerët janë amatorë ndaj historisë, arkivi është një shkollë e madhe.



Kristaq Dhamo: Arkivi duhet të pasurohet akoma më shumë

Gjendja e Arkivit të Filmit me aq fond sa ka pasur është menaxhuar si duhet, por çështja nuk ngelet këtu, pasi duhen marrë masa që ky arkiv të pasurohet më shumë. Ka qenë një kohë kur pranë arkivit ishte një sektor përkatës që quhej i pasurimit me materiale, për të cilat nuk interesohet as televizioni, as Kinostudio, as filmi dokumentar, kryesisht ishte për personalitete të shquar, jeta e tyre private, mundimet, ose gjurmonte gjëra të rëndësishme historike, të cilat duhet të ruhen në memorie vizive. Mendoj që të bëhet një ligj qeveritar, i cili të detyrojë të gjithë qendrat televizive ose filmike, që një kopje të sjellin në arkiv, dhe të pasurohet, sepse gjatë kësaj kohe nuk është pasuruar dhe kjo është shumë rëndë.

Shfaqet për herë të parë një kolazh filmik që daton nga viti 1911

Arkivi i Filmit, 65 vjet imazhe dhe histori në ekran



Izaura Ndoj

izaurandoj@kohejone.com

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit festoi dje 65-vjetorin e krijimit të tij. Imazhet bardhezi të qyteteve të shkatërruara, varfëria e skajshme, qëndresa e popullit shqiptar kaluan para syve të shumë kineastëve që ishin mbledhur për të kremtuar këtë përvjetor. Në ceremoninë festive të organizuar me rastin e këtij përvjetori të ftuar ishin emra të njohur të kinematografisë ndër vite, regjisorë, skenaristë dhe aktorë të cilët kanë dhënë kontribut të shquar në kinemanë shqiptare të para dhe pas viteve '90, të cilët vunë në pah mungesën e pasurimit të këtij fondi filmik, të vetmin që ka Shqipëria. Në fjalën përshëndetëse, drejtoresha e AQSHP-së, Elvira Diamanti, bëri një historik të shkurtër të Arkivit, si dhe vlerësoi lartë ato figura që kanë kontribuar për pasur-

imin e këtij fondit të art filmik. I pranishëm në këtë përvjetor, ministri Bumçi foli mbi rëndësinë institucionale të Arkivit të Filmit si dokumentues ndër të tjerash i mjaft ngjarjeve të rëndësishme historike, për të cilat në fondin e këtij Arkivi ndodhen me qindra filmime të ndryshme. **Shkodra e 1911-s dhe historia e shtetit shqiptar**
Në kuadër të 100-vjetorit të themelimit të shtetit shqiptar, AQSHP kishte përgatitur një material filmik, rreth '30-s, me momentet më të rëndësishme në historinë e Shqipërisë përgjatë gjithë shek. XX dhe fillimit të shek. XXI ku të pranishmit u njohën me historinë e popullit shqiptar, përndjekjet, vuajtjet dhe deri në ditët e sotme. Dokumentari nisi me filmimet të vitit 1911 me rrethimin e Shkodrës e deri në vitin 2009 me hyrjen e Shqipërisë në NATO. Shkodra e rrethuar e vitit 1911 është xhiruar nga operatorët francezë të kohës. Ata i takonin shoqërisë së filmimit "Pate" dhe kanë mundur të kapin në kamerën e tyre hyrjen e malazezëve në qytetin verior. Nuk dihet se si "u poros-

it" ky material filmik as nëse u porositi, por malazezët i morën këto pamje prej francezëve dhe i ruajtën në arkivat e tyre. Pjesë të tjera të dokumentarit ishin filmimet e rralla të ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri, dasma shkodrane dhe ritualet asokohe, vizita e presidentit Zog në Shkodër, festimet e 25-vjetorit të Pavarësisë, martesat madhështore e mbretit Zog, pushtimi italian,



pushtimi gjerman, zbarkimi i aleateve dhe Çlirimi në vitin 44. Më tej, dokumentari përfshinte disa momente kulmore të historisë së regjimit komunist, gjyqet, dënimet dhe vrasjet, ndërtimin e disa veprave me punë vullnetare si hekurudhat, si dhe momente pikante të miqësisë së diktatorit Hoxha me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën, deri tek rrëzimi i regjimit komunist dhe momentet kryesore të historisë së re të Shqipërisë periudhës së tranzicionit pluralist. Ky kolazh filmik u shoqërua edhe me një ekspozitë fo-

tografike ku emra dhe figura të shquar të kinemasë shqiptare kanë dhënë kontributin e tyre në pasurimin e këtij fondit të art filmik.

Krijimi

Në prill 1947, në bazë të vendimit 160 të Këshillit Ministerial, me dekret Nr. 314 të Ligjit Nr. 422 "Mbi shtetëzimin e kinemave", krijohet Ndërmarrja Kinematografike Shqiptare, fillimisht si një magazinë ruajtjeje për filmat e grumbulluara nga shtetëzimi i kinemave private. Pikërisht kjo datë është edhe themelimi i Arkivit të Filmit, sepse i gjithë fondi që ky arkiv ka trashëguar dhe ruan edhe sot, ka marrë fillimin nga grumbullimi i filmave pas shtetëzimit të kinemave private, duke u pasuruar më vonë me prodhimet e reja nga Kinostudio "Shqipëria e Re", pjesë e së cilës Arkivi i Filmit ka qenë që me themelimin e saj në 1952 e deri në 1997 kur u shkëput dhe doli institucion më vete nën varësinë e MKRS-së. Me shkëputjen nga ish-Kinostudio dhe funksionimin si institucion më vete, Arkivi mori edhe emërtimin Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit. Në këto vite është drejtuar nga Natasha Lako, Ilia Xhokaxhi, Kreshnik Hashorva, Artan Minarolli e së fundi Elvira Diamanti.



"Magjia e madhe", për herë të parë në qytetin e serenatave

Teatri "A.Z. Çajupi" i Korçës ka pritur me sukses premierën e re "Magjia e Madhe", komedi nga Eduardo de Filippo, me regji të Hervin Çulit. Autori i madh italian De Filippo, me këtë komedi ngjitet për herë të parë në skenën e teatrit të famshëm të qytetit të serenatave e karnavaleve, që i shkon aq për shtat dhe atmosferës së kësaj komedie. Konflikti i burrit me gruan është ndër më të vjetrit në botë, por komedia tingëlton aktuale në krizën e besimit që përjeton sot familja shqiptare në proceset e demokratizimit liberal të saj dhe të shoqërisë. Nga ana tjetër, komedia është edhe një apel për

mirëkuptim, tolerancë e më shumë dashuri. Natyrisht, si komedi e tipit Molerian, me një personazh të tillë në qendër si De Speto, shfaqja nuk do t'ia kishte arritur qëllimit të saj, pa lojën me nivel të lartë artistik dhe sjelljen "të gjallë" të kësaj figure, nga aktori i shquar i teatrit shqiptar Marko Bitraku. De Speto i Bitrakut është një karakter i skalitur me mjeshtëri aktoriale, që i shtohet galerisë së varfër të teatrit në këto vite tranzicioni, duke u pasuruar atë me vlera të vërteta artistike. Duke pasuar rolin e Albano Prodanit-Magjistari, lojën plot freski e humor të Natasha Andonit, Shkëlqim Jaupit etj.

SHFAQJA





...me B-Real nga Cypress Hill...



... me Akon...



Yjet e mëdha bëjnë një jetë të veçantë. Çdo hotel apo prapaskenë për artistët, me të cilët unë kam punuar kanë pasur kërkesa të mëdha. Nuk do ta harroj kurrë kur në një prej festivaleve Eminem dhe Jay-Z direkt nga aeroporti ateruan në skenë me helikopter. Edhe Rihanna ka kërkesat e mëdha. Ajo kërkonte tri parukiere, 10 kilogramë akull dhe tri banja në hotel 'Hilton' rezervim komplet, me Whirlpool Jacuzzi dhe gjithçka tjetër të nivelit më të lartë

Grëfhet i riu shqiptar që punon për agjencinë europiane "MOS Music Entertainment" në Zvicër

Nexhat Morina, një shqiptar i suksesshëm me yjet botërorë



Nexhat Morina me "The game"

Keni qenë në koncertin e Busta Rhymes, apo keni dëgjuar për këtë ngjarje? Keni besuar se vërtet një shqiptar mund të ketë kontakte të zgjeruara me superyjet botërorë, të cilët ai mund t'i sjellë në Kosovë dhe që ju keni ëndërruar t'i shihni? Ky është Nexhat Morina, shqiptari, i cili jeton në Zvicër dhe që punon për agjencinë më të madhe zvicerane dhe europiane të organizimit të koncerteve "MOS Music Entertainment". Ka kontakte me shumë artistë të njohur botërorë, disa prej tyre i ka sjellë edhe në Kosovë. Në një intervistë për "Telegraf" në Kosovë, Nexhat Morina rrëfen nga afër e përjeton me qindra herë brenda vitit atmosferën e punës me yjet e mëdha botërorë, kërkesat që ata kanë dhe çdo gjë tjetër.

Kush është Nexhati, ku jetoni dhe si e përkufizoni profesionin, të cilin e ushtroni?

Unë jetoj në Zvicër, në Biel/Bienne. Kam kryer shërbimin ushtarak në Zvicër. Unë mbaj dy punë, vërtet nuk e di se cilin e kam profesion primar, megjithëse më shumë jam i përkushtuar në menaxhimin dhe aranzhimin e koncerteve për kompaninë "MOS Music Entertainment".

Si shkuat në Zvicër dhe a keni menduar ndonjëherë se do të keni suksese të tilla?

Isha 17 vjeç kur u largova nga Kosova. Familjen e kam pasur në Gjermani, madje edhe gjyshi im ka qenë atje, kurse unë kalova në Zvicër, sepse babai im nuk më lejoi asesi që të lëshoj Kosovën. Isha nxënësi i shkëlqyeshëm, kurse braktisa shkollën dhe ika jashtë vendit. Qysh nga rinia ime e hershme kam qenë roker, "hipie" i gjallë. Por, kurrë nuk kam besuar se një ditë do të kaloj në gangsta rap.

Me cilët artistë keni punuar deri tani dhe me cilët artistë botëror nuk jeni takuar ende?

Deri tani kemi punuar me shumë artistë, duke filluar nga "Old School" deri te "New School". Kemi punuar prej KRS-One, mësuesit të hip-hopit,

deri tek Eminemi. Kemi punuar me Jay-Z, Kanye West, Lladakris, Snoop Dogg, Busta Rhymes, Cypress Hill, Wu-Tang Clan, Ice Cube, Sean Paul, The Game, Akon. Ka edhe shumë e shumë të tjerë, me cilët nuk jam takuar ende. Dr.Dre ka refuzuar ofertën më të madhe që mbahet mend, por nuk jam takuar as me Lil Wayne, i cili ka një ndalesë për udhëtime në Europë për shkak të problemeve ligjore. Këta dy reperë, ende nuk i kam takuar.

Po me yje femra keni punuar ndonjëherë?

Po, kemi punuar me Ciara, Lil Kim, Missy Elliot, kurse të punosh me Adele dhe Jennifer Lopez është problem, pasi ata nuk bëjnë kurrë turne europiane - organizojnë një deri në dy koncerte të mëdha në vit.

Cili koncert ka qenë më i miri për ju, kur dihet se keni përjetuar dhe aranzhuar me mijëra koncerte deri tani në karrierën tuaj?

Po, ka shumë. Kur flasim për koncertet, mua personalisht më ka pëlqyer koncerti i Unikkatilit në Zvicër, sepse aty është dëgjuar vetëm publiku, që i dinte të gjitha këngët në mend. Aty isha mysafir i koncertit, kurse të gjitha autostradat e Zvicrës para dhe pas koncertit kanë qenë plot

me flamuj kombëtarë. Tipike për traditën tonë, e cila m'u kujtua në ato momente, pasi nuk e kam përjetuar një kohë të gjatë.

Keni udhëtuar shumë, veçmas me yje të mëdhenj botërorë. Çfarë mund të na tregoni për jetën e këtyre yjeve V.I.P, me të cilët keni qenë bashkë nëpër turne?

Yjet e mëdha bëjnë një jetë të veçantë. Çdo hotel apo prapaskenë për artistët, me të cilët unë kam punuar kanë pasur kërkesa të mëdha. Madje, kërkohin produkte që nuk ekzistojnë në Zvicër dhe ka pasur raste kur është dashur të udhëtojtë tërë natën me veturë për të blerë një gjë fare të thjeshtë. Kushtet i kanë në nivel jashtëzakonisht të lartë. Nuk do ta harroj kurrë kur në një prej festivaleve Eminem dhe Jay-Z direkt nga aeroporti ateruan në skenë me helikopter. Edhe Rihanna ka kërkesat e mëdha. Ajo kërkonte tri parukiere, 10 kilogramë akull dhe tri banja në hotel "Hilton", rezervim komplet, me Whirlpool Jacuzzi dhe gjithçka tjetër të nivelit më të lartë.

Cili është ushqimi dhe cilat janë pijet e preferuara të këtyre yjeve V.I.P botëror?

Ushqimi më i preferuar i tyre është pulë me oriz, sushi japoneze dhe biftek, kurse pijet më të preferuara janë Hennessy, Jamaica Rum, Vodka Grey Goes, Moet, Tequila Patron dhe Conjure.

Me cilin artist keni kaluar më së miri dhe me cilët mbani ende marrëdhënie të mira private?

Kam raporte të mira me Lladacris, X-Zibit dhe Cypress Hill. Me Lladacris njihemi familjarisht, kurse sa i përket X-Zibit mjafton të them se kam qenë në shtëpinë e tij në San Diego të Los Angelesit. Ka pasur raste kur edhe kam pasur probleme me artistë,

sepse shumë artistë të racës së zezë mendojnë se ne, raca e bardhë, jemi racistë, por i kam tejkaluar lehtë këto probleme, sepse jam rritur këtu dhe thajse me çdo racë kam kaluar mirë dhe jam integruar me sukses. **Çfarë mendoni për artistët shqiptarë, a janë të denjë sa për t'i quajtur V.I.P?**

Nuk mund të them se artistët e Kosovës janë V.I.P. Nuk funksionon asgjë në Kosovë. Nuk ka të drejtë autoriale dhe asnjë radio nuk funksionon si duhet. Dhe asnjë artist i ri nuk zbulohet, sepse nuk funksionon asgjë. Kam respekt për grupin NR dhe White OG, që dikur kanë qenë liderët e "Underground" rap dhe në këngët e tyre kanë pasqyruar realitetin. **Sipas jush, a ka gjasa që ndonjëri prej këtyre artistëve aktualë, që janë në top të skenës shqiptare, të shpërthejnë në skenën botërore të muzikës?**

Assesi. Rita Ora dhe Action Bronson dihet se tashmë janë shqiptarët më të famshëm në botë në sferën e muzikës, kurse mundësinë për sukses ndërkombëtar ka pasur edhe Unikkatili, por Rebeli është rebel dhe ai ka refuzuar këtë mundësi.

Siç e dimë keni kontakte me reperin Rebel a.k.a Unikkatil, i cili është i njohur në gjithë trojet shqiptare. Jeni ndër të paktë njerëz që keni kontakte me të. Si e vlerësoni këtë kontakt të rrallë me një prej reperëve më të mirë që ka gëzuar historia e repit shqiptar? A mund të zbulosh për fansat e tij ndonjë detaj interesant?

Po, kam kontakte me të gjithë anëtarët e TBA. Unë mund të them se në fillim i kam dëgjuar amerikanët, teksa më pas Unikkatili ishte i pari që bëri gangsta rap në Kosovë. Albumi i parë i Unikkatilit, "Unikkatil prezanton TBA" është albumi më i mirë i të gjitha kohërave. Aty shumë shqiptarë kanë mësuar shumë gjëra dhe njerëzit e kanë ndërjet veten shqiptarë. Dhe i vetmi koncert i mbajtur në Zvicër i Unikkatilit nuk kishite leje nga shteti zviceran, që e shihte Viktorin si nacist kundër Serbisë.

Punën më të madhe në këtë koncert e ka bërë Lorenc Palokaj. Por, se kush është Unikkatili i vërtetë do të shihni më 15 korrik në stadiumin e Prishtinës. Do të befasoheni të gjithë. **Faqe të ndryshme nëpër rrjete sociale i shohin yjet botërorë si të kontrolluar nga i ashtuquajtur rendi i ri botëror, apo "Illuminati". Edhe juve ju kanë cilësuar shpeshherë si të tillë. Na tregoni çfarë është ky fenomen?**

Shpeshherë më thonë se edhe unë jam Illuminati. Kjo është bërë shumë e madhe nëpër internet. I kanë përzier shumë e shumë gjëra, kurse unë kam lexuar shumë për Illuminatit. Ekziston që nga viti 1776. Mund t'iu them që të shikoni datat e artistëve, të cilët kanë vdekur dhe shikoni se çfarë mund të gjeni të përbashkët. Dhe mos iu besoni teksteve apo rrobave të yjeve të mëdha. Në ditën që një artist i madh nënshkruan kontratë me një "label" të madh si Def Jam Record apo Cash Money Records etj., për mua ai artist e ka nënshkruar me gjakun e tij!

Shumë koncerte janë organizuar së fundmi në Kosovë. Me cilat kompani keni punuar deri tani?

Tani për tani kam punuar vetëm me NextLevel dhe Duplex Club Prishtina. Mendoj se do të punojmë edhe me agjenci të tjera kosovare.

Dhe, shpresoj që në fund ta kesh rezervuar ekskluzivitetin për ne. Kush do të jenë artistët e mëdhenj që do të performojnë në Kosovë gjatë këtij viti dhe vitin e ardhshëm?

Do të ketë shumë artistë të mëdhenj vitin tjetër, të cilët do t'i zbuloj kur të vijë koha ekskluzivisht për "Telegrafin", pasi e kam problem të merrem me mediat tjera, sepse ka shumë keqkuptime dhe keqpërdorime nga mediat në Kosovë. 100% është i sigurt koncerti i Busta Rhymes, por edhe disa artistë të tjerë, të cilët me kohë do t'i zbuloj për "Telegrafin", pasi të përfundojnë festivalet në Europë. Në tetor do të vijë njëri nga legjendat e N.W.A që përbëhet nga Ice Cube, Dr. Dre dhe Eazy E.

GOSSIP

Çiljeta Xhilaga feston me tifozët e Skënderbeut

Tulli kampion për të dytin vit radhazi dhe për të tretën herë në histori e ka kthyer Korçën në epiqendrën e festës gjatë ceremonisë së dorëzimit të trofeut. Në një koncert festiv në stadiumin "Skënderbeu", presidenti i FSHF-së, Armand Duka, ka dhënë edhe medaljet për lojtarët kampionë të Kategorisë Superiore, si dhe trofeun e kampionatit. Festa e titullit kampion ka zgjatur deri në orët e para të mëngjesit të së hënës, ku protagonistët e titullit kanë dalë edhe në qytet për të shfaqur me krenari trofeun. Pjesë e këtyre festimeve duket se është bërë edhe këngëtarja Çiljeta Xhilaga, e cila e ka ndezur më shumë atmosferën. Këngëtarja kishte veshur një fustan të shkurtër gri, dhe një palë taka "pink", që e tregojnë atë shumë seksi dhe provokuese. Ajo kishte vënë në qafë edhe shallin e skuadrës së Skënderbeut. Këngëtarja kohët e fundit thuhet se është ndarë edhe nga i dashuri i saj, por që në "Facebookun" e saj nuk i ka hequr fotot e ish-të dashurit. Por kjo nuk e ka penguar këngëtarën të vazhdojë përpara me aktivitetin e saj artistik dhe atë privat. Pak ditë më parë, Çiljeta ka njoftuar edhe hapjen e biznesit të saj të ri të veshjeve, që do të quajë "Just Çiljeta".



Grupi i njohur rock kosovar "Jericho", të premtën me koncert në Tiranë

Grupi i njohur kosovar rock "Jericho" do të mbajë një koncert në kryeqytetin shqiptar. Tirana do të jetë mikpritësja e katërshes nga Prishtina, në koncertin që do të mbahet mbrëmjen e së premtës. Pesëmbëdhjetë këngë, që do të shtrihen në rreth 75 minuta performansë pandërprerë, është "menyja", me të cilën "Jericho" do të udhëtojë për në Tiranë. Për "Jerichon" është hera e parë që mban koncert në kryeqytetin shqiptar, edhe pse grupi atje ka pasur disa paraqitje. "Nuk mund të mohoj faktin

që kemi një lidhje pak më emocionale të performojmë në vendet ku flitet gjuha shqipe", ka thënë lideri i grupit, Petrit Çarkaxhiu. "Me shumë kënaqësi kemi pritur ftesën për të performuar në Tiranë", - ka shtuar ai. Por Çarkaxhiu nuk ka folur për atë që pret nga publiku në Shqipëri. "Nuk është se mund të them nëse do të mbushim sallën. Por po shoh që ka mjaft interesim për koncertin tonë atje. Të shohim, jemi shumë kureshtarë", - ka thënë rokeri në një prononcim për mediat kosovare.



KENGETARJA



Rita Ora, dashuria e të rinjve në botë

Është kthyer në një divë të vërtetë shqiptarja Rita Ora. Nuk është se e duan vetëm shqiptarët, por edhe të huajat, madje, siç e shihni në këtë foto që zbuluam, këta të rinj sapo kanë marrë një autograf dhe një CD nga Rita Ora dhe duken se janë shumë të gëzuar për këtë. Këngëtarja 21-vjeçare, e cila për një kohë të shkurtër ka kthyer nga vetja vëmendjen e medieve botërore, ka vendosur që suksesin e saj të fundit t'ua dedikojë bashkëkombësve të saj shqiptarë. "I falënderoj të gjithë shqiptarët anembanë botës për

përkrahjen. Ju dua, Rita Ora", - ka shkruar Rita Ora në profilin e saj në rrjetin social "Facebook", disa orë pasi i është gëzuar lajmit se kënga e saj "R.I.P" kryeson top-listën e këngëve më të shitura britanike.



Kujdes, po vjen Unikkatili

Reperi kosovar që jeton në RSHBA, Viktor Palokaj, tashmë ka nisur që ta nxehtë skenën e repit në Kosovë. Në një video montazh ku janë të përfshirë edhe titujt e gazetave dhe raporte televizive për Unikkatlin, ku veçohet titulli "Unikkatili vjen në Kosovë, Getoar Selimi nuk ka koment", - tregon vetëm fillimin e një loje verbale në mes dy labeleve, TBA dhe Baba Records. Një ndër bluzat që pritet të jenë të veshuar në këtë koncert, është edhe "You see me, Hi Hater", dhe në fund vjen porosia e Unikkatit, "See you there". Unikkatili pritet të mbajë koncert gjatë verës në Kosovë.



Adelina Berisha garon për Miss Benelux 2013

Është një vajzë që provon fatin, megjithëse e ka emrin e njëjtë me një këngëtare të njohur kosovare, ajo ndodhet në mesin e 12 vajzave finaliste për Miss Benelux 2013. Fjala është për bukuroshen 17-vjeçare nga Peja, Adelina Berisha, e cila jeton në Antwerpen të Belgjikës. Sipas medieve belge, Adelina është një ndër favoritët kryesorë për fitimin e kurorës së më të bukurës së Beneluxit.





Nuk dua që të bëhem enigmatike, por as nuk do të doja që të rrëfeja gjithçka, mendoj se sa i përket jetës private dhe ndjenjave njeriu duhet të jetë paksa i rezervuar dhe të mbajë edhe gjëra për vete, të paktën për momentin. E vërteta do të zbulohet me kohën

Bukuroshja kosovare, në një intervistë për "Koha Tjetër"

Drenusha Latifi: Lidhja ime, koha do të zbulojë gjithçka



Yllka Selita

yllkaselita@kohajone.com

E është një nga vajzat më të bukura në Kosovë dhe për të gjithë meshkujt mund të jetë një ëndërr. Kjo është Drenusha Latifi, por nëse dikush ka pasur shpresa se mund të lidhet me të, tashmë kjo mundësi nuk ekziston, sepse Drenusha është në një lidhje. Megjithatë ne tentuam që të merrnim vesh diçka më shumë sa i përket dashurisë së saj të re, ajo nuk u prononcua për emra të përveçëm, duke thënë se "kur të vijë momenti do ta zbuloj", por pranon faktin se është në një lidhje dhe për më tepër të hapur, pasi ky është edhe statusi i saj në "Facebook". Por këto dhe shumë të reja të tjera që kanë ndodhur në jetën e Drenushës, ajo i ndan në një intervistë për lexuesit e "Koha Tjetër".



Këto ditë është folur mbi një lidhje tuaj të mundshme, si qëndron e vërteta?

Nuk dua që të bëhem enigmatike, por as nuk do të doja që të rrëfeja gjithçka, mendoj se sa i përket jetës private dhe ndjenjave njeriu duhet të jetë paksa i rezervuar dhe të mbajë edhe gjëra për vete, të paktën për momentin. E vërteta do të zbulohet me kohën.

Ju keni postuar disa foto ku tregohen dhurata të çmuara, cili ishte personi që jua dhuroi?

Më vjen keq që nga një anë "Facebook" bëhet një "spion" i yni, sa i përket gjërave që shihen. Sepse, për sa i përket të tjerave, sigurisht që duhet prononcimi im dhe lidhur me pyetjen tuaj unë po përgjigjem, ato janë akoma top sekret dhe detyrimisht edhe personi që mi ka dhuruar mbetet i tillë.

Momentalisht statusi juaj në "Facebook" është "në një lidhje të hapur" që do të thotë?

Sa këmbëngulës jeni ju gazetarët. Statusi im do të thotë "Pikërisht atë që kam shkruar, në një lidhje të hapur dhe sado që të pyesni, unë ende nuk do ta bëj të ditur se për çfarë flitet (qesh).

Gjatë kësaj periudhe keni qenë në disa vende shumë të bukura si në MonteKarlo dhe në Kanë, gjë që e vërtetuan edhe fotot e tua, cila ishte arsyeja e këtij turneu të mrekullueshëm?

Ishte tamam ashtu siç u shprehët edhe ju, një turne shumë i bukur. Ato janë nga vendet më të bukura dhe mua mu dha mundësia që t'i vizitoj. Mbi të gjitha, arsyeja krye-

sore ishte kureshtja për t'i parë këto vende, të cilat janë edhe një mundësi shumë e mirë edhe për të kaluar disa ditë pushime të shumë të bukura.

Cila është stina që pëlqeni më së shumti dhe arsyen pse?

Po përgjithësisht më pëlqejnë të gjitha stinët e vitit, sepse secila ka specifikën e vet. Por, nëse do të më duhej që të zgjidhja, do të veçoja dimrin, sepse mendoj se është një stinë më e qetë dhe më intime. Duke qenë se kalojmë më shumë kohë brenda në shtëpi, më duket se ka shumë më tepër intimitet sesa në stinët e tjera, ku një pjesë të mirë të kohës e kalojmë jashtë dhe në shoqërinë e njerëzve të tjerë. Për më shumë nuk i përballoj dot gjatë temperaturat e larta...

Veshja juaj e preferuar për këtë stinë?

Por siç ju thashë edhe më lart, unë nuk e duroj shumë vapën dhe për këtë arsye mundohem që të zgjedh veshjet që janë më të rehatshme e që për mua janë veshjet sportive. E para, sepse njeriu mund të ndihet më rehat dhe, e dyta, në këtë mënyrë evitohen edhe përdorimi



i takave të larta që në stinën e nxehta janë edhe më të lodhshme.

Do t'ju pëlqente të bënit pushime në det apo në mal?

Po kur është fjala për të bërë pushime, unë nuk kam shumë pretendime, sepse vetë fjala pushime presupozon diçka të mirë dhe relaksuese. Pra, nuk mund t'i veçoj, pasi unë bëj pushime edhe në mal edhe në det, sepse më pëlqejnë të dy, sepse mund të organizosh gjëra shumë të ndryshme.

Mendonit se artistët në një farë mënyrë bëhen vetë pre e gazetarëve?

Nëse e keni fjalën për publikimet e bëra në rrjetet sociale, unë do të thosha se nuk e mendoj kështu, pasi nuk janë vetëm gazetarët miq në "Facebook". Aty publikohen më së shumti informacione për miqtë që i sheh pak më rrallë apo të afërmit dhe nuk besoj se artistët duan të behen pre me dashje. Kjo sa i përket artistëve në përgjithësi, nuk mund të flas për ata artistë që e kanë në një farë mënyre publicitet punën që ju bëhet nga gazetarët dhe për këtë nuk duhet të ndihen të cenuar, sepse ka plot mënyra për të mos u bërë pre e që ta evitosh nëse nuk do.

Çfarë prisni ju nga stina e verës?

Duke qenë se është një stinë e nxehtë edhe unë si të gjithë të rinjtë besoj, pres shumë dashuri, shumë surpriza, sepse më pëlqejnë shumë surprizat dhe që kënga ime më e re të pritët sa më mirë nga fansat e mi dhe nga të gjithë shqiptarët.

Dihet se vera sjell edhe shumë krijime të reja, po ju a keni në plan për të sjellë një klip të ri këtë sezon?

Sigurisht që nuk do të mungojë në tregun artistik këtë verë edhe një

këngë dhe një klip i imi i ri, të cilin jam duke e përgatitur dhe ende jam në punë e sipër. Nuk do të mungoj as këtë verë, sepse çdo vit i kam vënë synim vetes që në këtë sezon kur dëgjohet muzikës më shumë se në çdo stinë të vitit mendoj, të sjell diçka të re.

Si titullohet kënga dhe kur pritet ta lanconi së bashku me videoklip?

Kënga ime më e re do të titullohet "Futur Love" dhe mendoj se për 2 apo mbase 3 javë shpresoj se do të dalë në treg. Them shpresoj, pasi jo gjithçka varet nga ne, në momentin që puna jonë mbaron fillon puna e montazhit dhe sigurisht që disa gjëra nuk varen nga ne...

Në disa foto të publikuara së fundmi, duke për një moment se keni ndryshuar ngjyrën e flokëve, mos ndoshta do të bëheni bionde?

Po, keni të drejtë, pasi nuk është një efekt dritash. Jam duke e ndryshuar ngjyrën e flokëve, por duke qenë se i kam pasur shumë të errëta po mundohem që t'i hap avash-avash, pra jam ende në proces të hapjes së ngjyrës dhe besoj se këtë vit do të jem bionde për pak kohë.

A keni menduar se ku do t'i kaloni pushimet?

Po siç e keni vënë re, mua më pëlqejnë shumë pushimet dhe mbi të gjitha që të udhëtoj. Po ju them edhe diçka të vogël që sapo jam kthyer nga Turqia. Nuk e di si do të jenë angazhimet e mia verore nëpër koncerte të ndryshme, pasi kam marrë disa oferta, dhe një ndër arsyet që shkova tani për pushim ishte edhe kjo, se nuk e di kur do të shkoj prapë me pushime. Por diçka është e sigurt se me siguri do të zgjedh një vend shumë të bukur.





GOSSIP

Jennifer Lopez fiton garën me Cameron Diaz

Të dyja konsiderohen si "sex symbols", por Jennifer Lopez dhe Cameron Diaz kanë pamje krejt të ndryshme. "Përballja" e tyre sidomos në mbrëmje, ku janë të ftuar personazhe VIP është tepër interesante. Këtë radhë ato pozuan bashkë në premierën e filmit të tyre, "What To Expect When You're Expecting". Të dyja kishin veshur fustane shumë të bukura, por secila prej tyre josh-te në një mënyrë totalisht ndryshe nga tjetra. Diaz u shfaq me një fustan të zi të shkurtër, ndërsa J.Lo provokonte me pjesën e sipërme të fustanit, ndërsa pjesa e poshtme e veshjes së saj e mbulonte tërësisht. Këngëtarja, aktorja dhe anëtarja e jurisë në spektaklin "American Idol" dukej si

një perëndeshë greke e veshur me fustanin e krijuar nga Maria Lucia Hohan. Fustani prej mëndafshi i rrinte për mrekulli 42-vjeçares seksi, nënë të dy fëmijëve, binjakëve Max dhe Emme. Edhe buzëkuqi i zgjedhur prej Jennifer ishte shumë i këndshëm dhe e kompletonte veshjen e saj, duke u përputhur totalisht me unazën dhe ngjyrën e thonjve. Ndërkohë, Cameron ishte më e thjeshtë në zgjedhjen e saj, por dukej shumë tërheqëse me fustanin e shkurtër të zi, i cili shkante për mrekulli me këpucët "nude" të Mary Jane. Por mund të thuhet me plot gojë se këtë radhë Jenn mundi kolegen Cameron, për pamjen e saj super të kuruar deri në detaje.



Sylvester Stallone, në pikturën e shekullit të 16-të

Ka gjithmonë diçka të re për të zbuluar në Qytetin e Vatikanit. Anthony Zonfrell, 20 vjeç, gjatë një vizite në qytetin e shenjtë bëri një zbulim kur pa aktorin Sylvester Stallone në një nga kryeveprat e Rafaelos. Nuk është me të vërtetë Stallone, por personazhi i pikturës ngjan me të vërtetë me personazhet Rocky dhe Rambo të interpretuar nga aktori. Po të shihen kockat e faqes, zgavrat e syve, hunda dhe flokët, personi në pikturën e Papa Gregorit IX është identik me Sly, që këtë verë do të rikthehet në ekran me "The Expendables 2". Megjithatë, nuk është hera e parë që aktorë të ditëve të sotme ngjajnë me personazhe të njohura që i përkasin së kaluarës. Disa mendojnë se aktori Jack Black dhe Paul Revere, protagonist i revolucionit amerikan të shekullit të 18-të, janë i njëjti person. Gjithashtu, një vit më parë dikush zbuloi foton e një ushtari të Luftës Civile, që ngjasonte shumë me aktorin Nicholas Cage. Në një intervistë për David Letterman, Cage pranoi ngjashmërinë, por theksoi se ai nuk është një udhëtar në kohë që vjen nga shekulli i 19-të. Ndërsa zëdhënësi i Stallone nuk ka bërë asnjë koment.



Jada Pinkett, gjithmonë pranë Will Smith

Rrinë gjithmonë bashkë në publik, ose sepse është dashuri e vërtetë ose për faktin që tabloidet flasin për një krizë në çift. Dhe për ta mohuar në një farë mënyre bëjnë këtë, pra ata shfaqen çift kudo. Fakti është se në turin e fundit të Will Smith me të tjerë në

promocionin e filmit "Men in black III" bashkëshortja e tij Jada Pinkett nuk ka humbur asnjë etapë, nga Japonia në Madrid ajo ka qenë gjithmonë prezent në tapetin e kuq. Tamam koha për të kujtuar: "Willi është i imi, mjerë kush e prek".

Megan Fox: Po, jam shtatzënë

Ylli i botës së filmit, Megan Fox, e konfirmoi që është shtatzënë pas spekulimeve disaditore që thoshin që ajo është me barrë. Për mediet e huaja, ajo e zbuloi se me bashkëshortin e saj, yllin e serisë së mirënjohur "Beverly Hills", Brian Austin Green-in, janë duke e pritur fëmijën e parë, për çka edhe janë jashtë mase të emocionuar. "Po, është e vërtetë se jam shtatzënë. Si unë edhe Brian jemi jashtë mase të kënaqur për këtë, dhe shpresoj që shtatzënia do të kalojë pa ndonjë komplikim dhe ta sjell në këtë botë një fëmijë të mrekullueshëm", - tha Fox. Ky do të jetë fëmija i parë për të, ndërsa bashkëshorti i saj tashmë e ka një djalë 10 vjeç, Kassius-in, nga martesja me Vanessa Marcil. Megan dhe Brian janë njohur në vitin 2004, gjatë një incidimi dhe lidhja e tyre përfundoi me martesë në qershor të vitit 2010.

Lady Gaga, në një thertore mishi?

Lady Gaga sërish ka imituar një fustan të krijuar nga mish i gjallë, ndërsa është fotografuar ngjitur me kafshë të varura njësoj si në një thertore. Këngëtarja aktualisht është duke bërë promovimin e albumit të saj të fundit "Born this away" dhe me veshje të ngjashme është paraqitur edhe më parë duke shkaktuar reagime të shumta nga aktivistët që mbrojnë të drejtat e kafshëve. Por Gaga është përfolur këto ditë edhe për një fotografi që

tregon Gagan duke shënjuar një unazë në gishtin e saj. Kjo foto ka nxitur spekulime se bëhet fjalë për një unazë fejeje. Mirëpo burime të afërta me krijuesen e hitit "Poker Face" kanë thënë për "TMZ" se nuk ka asgjë të vërtetë nga këto thashetheme dhe se unaza nuk ka kurrfarë domethënie të veçantë. Madje, thuhet se 26-vjeçarja i ka dhënë fund romancës me Kinneyn për shkak të problemeve që krijonte lidhja në largësi.





Nga një ndeshje e Kampionatit Kombëtar

KOMPETICIONET

S'ka pushime për skuadrat shqiptare, nisin përgatitjet për Kupat e Europës

Nuk do të ketë pushime të gjata për skuadrat shqiptare që kanë siguruar një vend në Europë. Teuta, Tirana dhe Flamurtari nuk e kanë luksin të relaksohen, për faktin se ndeshjet në Kupat e Evropës janë jo më larg se fillimi i korrikut. Disi më ndryshe për Skënderbeun, pasi kampioni i Shqipërisë do të luajë nga turi i dytë i paraeliminator të Kupës së Kampioneve, ndaj do ketë më shumë kohë në dispozicion për t'u përgatitur. Sipas programit të publikuar që më parë nga UEFA, më 25 qershor do të hidhet edhe shorti si për Ligën e Kampioneve, por edhe atë të Ligës së Evropës dhe nga aty skuadrat shqiptare do të mësojnë edhe kundërshtarët e tyre në kompeticionet pjesëmarrëse. Në bazë të formatit të zgjedhur nga UEFA,

kampioni i Shqipërisë do luajë në turin e dytë, i cili ka në përbërje 34 skuadra. Tre do të jenë fitueset që do vijnë nga turi i parë pre-eliminator dhe 31 të tjera të përzgjedhura në bazë të koeficientit që çdo shtet ka përfituar nga mbledhja e pikëve në 5 sezonet e fundit në Kupat e Evropës. Skënderbeu është renditur në mesin e ekipeve të konsideruara si më pak kompetitive të skuadrat që bëjnë pjesë në turin e dytë të Champions. Në këtë këndvështrim bardhekuqtë rrezikojnë që të përballen me ekipe mjaft të forta, të paktën teorikisht duke filluar që nga Bazeli i Zvicrës, Slovan Liberec i Çekisë, Salzburgu i Austrisë, Dinamo e Zagrebit (Kroaci), BATE Borisovi i Bjellorusisë, Partizani i Beogradit (Serbi) e deri kampioni i Suedisë, Helsingborg.



Artur Qoraj

arturqoraj@kohajone.com

Xhevahir Sukaj në Iran, Isli Hidi në Qipro dhe Besart Berisha në Australi

Tre shqiptarë fitojnë kampionatet e huaja

U larguan nga Shqipëria me mijëra kilometra larg, por në fund të fundit sakrificia vlejti. Edhe pse jo me peshë në tregun e futbollit vendas dhe në kombëtare, arritën të bëhen kampione në skuadrat ku dhe militojnë. Sezoni 2011-2012 ka kurorëzuar tre futbollistë shqiptarë që luajnë në ligat e ndryshme botërore. Atajanë Besart Berisha, Xhevahir Sukaj dhe Isli Hidi, që janë shpallur kampione në Australi, Iran dhe Qipro. Një sukses i jashtëzakonshëm për këta lojtarë, ku protagonist absolute i këtij sezoni ka qenë padyshim sulmuesi Besart Berisha, që doli dhe golashënuesi më i mirë, apo "Këpuca e artë". Sulmuesi 26-vjeçar la Gjermaninë për kontinentin e largët dhe shënoi 21 gola në total me Brisbane Roar, 19 prej të cilëve në sezonin e rregullt dhe 2 në finalen e madhe përballë Perth Glorit. Në këtë mënyrë, Berisha u bë protagonist absolut, duke i dhënë skuadrës së tij titullin e dytë radhazi në A-League australiane, duke vendosur edhe një rekord për gola të shënuar brenda një sezoni të vetëm. Sulmuesi që pritet



Besart Berisha

të rikthehet në përfaqësuese pas një mungese 18-mujore, fitoi "Këpucën e Artë", u rendit i dyti në

garën për lojtarin më të mirë dhe ishte në formacionin e vitit. Suksesin e festoi edhe Xhevahir

Sukaj në kampionatin Iranian. Sulmuesi i transferuar në janar 2012 të Sepahan Isfahan, duke e

ditur që po shkonte te skuadra kampione dhe që ishte sërish pretendente. Ambientimi dhe konkurrenca e madhe brenda skuadrës bën që hapësirat për 24-vjeçarin të ishin të kufizuara. Megjithatë, me kalimin e javëve, Sukaj e bindi trajnerin Kranjçar dhe gjatë këtyre katër muajve është aktivizuar në 9 ndeshje të ligës me emrin "Kupa e Gjirit Persik" dhe 4 në Champions League aziatike. Në total sulmuesi arriti të shënonte tre gola, dy në kampionat dhe një në Champions.

Në Qipro festoi edhe Isli Hidi. I mësuar me trofe gjatë karrierës në klubet shqiptare, gardiani ka fituar edhe kampionatin me AEL Limasolin. Portieri kuqezi e ka pasur të vështirë të gjente hapësirat e nevojshme për të luajtur, pasi argentinasi Degra ishte titullar i padiskutueshëm në klubin nga Limasoli. Hidi e mbylli kampionatin me vetëm një ndeshje të luajtur, por kjo absolutisht nuk mund ta ndalonte 31-vjeçarin që të festonte së bashku me shokët titullin e gjashtë në historinë e klubit qipriot. Por një sezon pozitiv mund të quhet edhe për Jahmir Hykën, i cili militoi tek Lucerne në Zvicër dhe nuk arriti dot të mposhte rivalët e Bazelit, që patën ecuri pozitive dhe në Champions. Gjithsesi shqiptari shkëlqeu edhe në lojë edhe në gola dhe skuadra doli nënkampione.

PAULO BENTO:

"Fituesi Europeanit do të dalë nga Grupi B"

Fituesi i Euro 2012 do të jetë nga "grupi i vdekjes", ku luajnë Gjermania, Holanda, Portugalia dhe Danimarka. Parashikimi vjen nga trajneri i përfaqësueses portugeze, Paulo Bento, gjatë konferencës për shtyp ku ai bëri publike skuadrën e përzgjedhur për aktivitetin kontinental, që nis më 8 qershor. Grupi B mbetet absolutisht më i vështiri në aktivitetin në Poloni dhe Ukrainë, megjithatë Bento është optimist për shanset e skuadrës luzitane dhe përcaktoi objektivin minimal, që është arritja e çerekfinaleve. "Objektivi ynë është i qartë dhe fillimisht duhet të punojmë që të arrijmë të paktën deri në fazën çerekfinale të Euro 2012, këtij aktiviteti të jashtëzakonshëm. Nuk do të jetë surprizë që fituesi i kampionatit evropian të vijë pikërisht nga Grupi B", - tha ai.

HOLANDË

Sara ngushëllon babanë futbollist për humbjen



Ndodh edhe kështu. Në ditët kur kampionatet janë përfshirë nga faza të skuadrave që kërkojnë mbijetesë apo bien, një skenë tepër trishtuese ka ndodhur në Holandë. Në Kategorinë e Dytë janë përplasur në play-out dy skuadra që kërkojnë të ngjiten në Erdevise, De Graafschap dhe Den Bosch, ku triumfuan të dytë. Por mesfushori holandez i De Graafschap, Rogier Meijer, e ka përjetuar keq humbjen dhe është shtrirë në fushë. Por një person shumë i rëndësishëm ka shkuar ta ngushëllojë atë dhe t'i japë zemër. Pikërisht vajza e tij e vogël Saara, 4-vjeçare, e cila i kërkon të çohet. Pamjet janë hedhur menjëherë në rrjetet televizive dhe kanë bërë përshtypje. Vajza e vogël ngushëllon babanë dhe i thotë; "Babi, s'ka gjë që humbe. Çohu tani!".





celio*
www.celio.com

Uije deri në -50%



TEG
tirana east gate

QTU
TIRANE - VLORE

Koleksioni Pranverë - Verë 2012

